



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Strategjia Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël në Kosovë 2021-2026

Programi për Remitencat dhe Pagesat – Kosovë
Financuar nga SECO

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

**Programi për Remitencat dhe Pagesat – Kosovë
Financuar nga SECO**

**Strategjia Kombëtare për Pagesat me
Vlerë të Vogël në Kosovë
2021-2026**

BOTUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Departamenti i Sistemeve të Pagesave

33 Garibaldi, Prishtinë 10000

Tel: +383 38 222 055

Fax: +383 38 243 763

Faqja e internetit

www.bqk-kos.org

Adresa elektronike

payment.systems@bqk-kos.org

Lista e Akronimeve dhe Shkurtesave:

ACH	Sistemi i Klirimit të Pagesave me vlerë të vogël
API	Application of Programming Interfaces – Aplikacion për Ndërlidhjen e Sistemeve
ATM	Automated Teller Machine - Bankomat
BE	Bashkimi Evropian
BIS	Bank for International Settlements – Banka për Rregullime Ndërkombëtare
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CDD	Customer Due Diligence – Vlerësim i Detajuar i Klientit
CFT	Combating the Financing of Terrorism – Lufta Kundër Financimit të Terrorizmit
ECA	Europa dhe Azia Qendrore
EMD2	Direktiva e Dytë për Lëshimin e Parave Elektronike
EMD2	Direktiva e Dytë për Lëshimin e Parave Elektronike
G2B	Government-to-Business – Pagesat e Qeverisë ndaj Biznesit
G2P	Government-to-Person – Pagesat e Qeverisë ndaj Individit
ID dhe TIK	Identifikimi dhe Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
IFJB	Institucionet Financiare Jo-Bankare
ILF	Intraday Liquidity Facility – Hua për likuiditet brenda ditorë
ITF/FMI	Financial Market Infrastructure – Infrastruktura e Tregjeve Financiare
IOSCO	Organizata Ndërkombëtare për Letrat me Vlerë dhe Komisionet
KKP	Këshilli Kombëtar i Pagesave
KPIT/CPMI	Komiteti për Pagesat dhe Infrastrukturën e Tregjeve
KYC	Know Your Customer – Njohja e Klientit Tuaj
NZT	Merchant Discount Rate – Norma e Zbritjes për Tregtarin
OJQ	Organizatata jo-qeveritare
OSP	Operator i Sistemit të Pagesave
OSHP	Ofrues i Shërbimeve të Pagesave
OTP	Money Transfer Operator – Operatorët për Transferimin e Parave
P2B	Person-to-Business – Pagesat e individit për biznesin
P2P	Person-to-Person – Pagesat e individit për individin
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PFMI	Parimet për Infrastrukturën e Tregjeve Financiare
POS	Point of Sale terminal – Pikat e Shitjes
PSD2	Direktiva e dytë për Shërbimet e Pagesave
RTGS	Real Time Gross Settlement – Sistem i Shlyerjes Bruto në Kohë Reale
SKP	Sistemi Kombëtar i Pagesave
SKPVV	Strategjia Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël
SPN	Sistemi i Pagesave Ndërbankare
SSI	Social Security Institute – Instituti për Sigurime Shoqërore
SHBK	Shoqata e Bankave të Kosovës
VAM	Middle Income Country – Vende me të Ardhura Mesatare
WBG	World Bank Group – Grupi i Bankës Botërore

Vërejtje:

Përdoruesit e këtij publikimi kërkohen të citojnë burimin.
Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2021),
Strategjia Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël në Kosovë

PËRMBAJTJA:

FALENDËRIME	6
PËRMBLEDHJE	7
I. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI PAGESAT ME VLERË TË VOGËL	12
Akte të kryesor	12
Korniza ligjore dhe rregullative	13
Përfshirja financiare në Kosovë nga perspektiva e pagesave	14
Infrastruktura financiare në mbështetje të pagesave me vlerë të vogël në Kosovë	15
Infrastruktura e ID dhe TIK në Kosovë	16
Instrumentet e pagesave me vlerë të vogël të përdorura në Kosovë	17
Qeveria si përdoruese e shërbimeve të pagesave	21
Pikat dhe kanalet e qasjes në shërbimet e pagesave në Kosovë	22
VIZIONI DHE STRATEGJIA PËR ZHVILLIMIN E NJË SISTEMI TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL NË KOSOVË	25
II.1 Parimet udhëzuese	26
II.2 Fushat dhe veprimet strategjike	30
III. ZBATIMI I STRATEGJISË KOMBËTARE TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL: ROLET, PËRGJEGJËSITË DHE MONITORIMI I PROGRESIT	41
III.1 Rolet dhe Përgjegjësitë	42
III.2 Monitorimi i Progresit	44
III.3 Plani i implementimit	46
Shtojca 1. Fjalor i termave të përzgjedhur	51
Shtojca 2. Udhëzimet e Bankës Botërore për Zhvillimin e një Strategjie Gjithëpërfshirëse për Reformimin e Pagesave me Vlerë të Vogël	55
Shtojca 3: KITP (CPMI) – Banka Botërore “Aspektet e Pagesave të Përfshirjes Financiare” ---	56
Shtojca 4: KSPSH (CPSS) – Banka Botërore “Parimet e Përgjithshme për Shërbimet Ndërkombëtare të Remitencave / Dërgesave të Emigrantëve” dhe Role të Ngjashme	57

LISTA E GRAFIKËVE

Grafik 1. Volumi i tërheqjeve cash sipas formës së qasjes-----	17
Grafik 2. Tërheqjet cash sipas formës së qasjes -----	17
Grafik 3. Norma e rritjes së tërheqjeve cash sipas formës së qasjes-----	19

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Të dhëna bazike për posedimin e llogarive -----	16
Tabela 2. Llojet e ndryshme të pagesave, bazuar në kombinimin pagues – i paguar -----	25
Tabela 3. Numri i transaksioneve të iniciuara nga konsumatorët (individët dhe bizneset) -----	33
Tabela 4. Numri i degëve të bankave për 100,000 banor – Vendet e Ballkanti Perendimor (2017)-----	37
Tabela 5. Numri i ATM-ve dhe POS-ve për 100,000 të rritur – Vendet e Ballkanit Perendimor (2018)-----	54
Tabela 6. ATM-të dhe Terminalet POS në Kosovë (2019) -----	72
Tabela 7. Variabla të ndërmjetme për vlerësimin e progresit të zbatimit të SKPVV-së -----	73
Tabela 8. Plani i implementimit të SKPVV-së në Kosovë-----	74

FALENDËRIME

Strategjia Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël në Kosovë, është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të akterëve të sektorit publik dhe atij privat, të udhëhequr nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është falënderuese ndaj përfaqësuesve të ministrive dhe agjencive tjera qeveritare, bankave, institucioneve financiare jo-bankare dhe akterëve tjerë relevant, për kohën dhe përkushtimin e tyre përgjatë disa takimeve bilaterale të realizuara lidhur me këtë strategji. Pa kontributin e këtyre përfaqësuesve nuk do të ishte i mundur edhe përpilimi i këtij dokumenti të rëndësishëm për fushën e pagesave.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, falënderon ekipin e Grupit të Bankës Botërore (Grupi për Zhvillimin e Sistemeve të Pagesave – Financat, Konkurrueshmëria dhe Inovacioni) në përbërje të Oya Pinar Ardic Alper, Holti Banka, Anjeza Beja, Biagio Bossone, Bernardo Barradas, Nenad Bosiljeic, Edlira Dashi, Ahmed Faragallah, Peter Jensen, Gynedi Srinivas dhe Ceu Pereira (ish anëtar i Bankës Botërore), për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre në përgatitjen dhe zbatimin e disa programeve të ndryshme reformuese në fushën e pagesave në Kosovë në përgjithësi dhe për mbështetjen e tyre në përgatitjen e këtij dokumenti në veçanti, si një nga rezultatet kryesore të Programit të Remitencave dhe Pagesave (Remittances and Payments Program – RPP), të financuar nga Sekretariati Shtetëror i Zvicrrës për Çështje Ekonomike (Switzerland's State Secretariat for Economic Affairs - SECO).

PËRMBLEDHJE

Qasja strategjike e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e pagesave me vlerë të vogël në Kosovë, është ndërtuar me një vizion të qartë: krijimi i një tregu modern dhe gjithëpërfshirës të pagesave me vlerë të vogël, të mbështetur në infrastrukturë të sigurt dhe efikase të pagesave dhe me një gamë të gjerë të instrumenteve dhe shërbimeve të pagesave, të cilat i përmbushin nevojat e të gjithë qytetarëve.

Strategjia Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël (SKPVV) 2021-2026 është ndërtuar me përpjekjet e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) në koordinim me autoritetet tjera të sektorit publik dhe atij privat, me qëllim të modernizimit të sistemit kombëtar të pagesave (SKP). Në mesin e arritjeve të deritanishme, BQK ka implementuar një sistem të sigurt dhe efikas të kliringut dhe shlyerjes së pagesave me anë të sistemit ndërbankar të pagesave, ka zhvilluar një kornizë të shëndosh ligjore dhe rregullative dhe është duke përgatitur legjislacionin e ri, ka ndërtuar një kornizë të bashkëpunimit formal ndër institucional përmes Këshillit Kombëtar të Pagesave nën udhëheqjen e BQK-së, si dhe ka avancuar kërkimet në fushën e sistemeve të pagesave. Përgjatë pesë viteve të fundit, pagesat elektronike janë rritur në vazhdimësi, edhe pse volumi i këtyre transaksioneve është ende relativisht i ulët në krahasim me volumin e përgjithshëm të transaksioneve me para të gatshme, megjithatë tani janë bërë të disponueshme edhe instrumente të reja të pagesave elektronike (si paraja elektronike).

SKPVV ofron një nivel të lartë të udhëzuesit strategjik për rrugën deri te krijimi i një tregu kombëtar gjithëpërfshirës dhe modern të pagesave, në linjë me praktikat më të mira dhe standardet ndërkombëtare, duke u bazuar në gjashtë parimet udhëzuese¹:

1: Transparenca, drejtësia dhe mbrojtja e përdoruesve. Transparenca është vitale për rritjen e konkurrencës dhe fuqizimin e mbrojtjes së përdoruesve të pagesave me vlerë të vogël. Drejtësia në tregun e pagesave me vlerë të vogël siguron pjesëmarrësit dhe akterët se interesat dhe nevojat individuale të tyre merren në konsideratë dhe adresohen në mënyrë adekuate. Përpjekjet për mbrojtjen e konsumatorit zvogëlojnë disbalancat e informacionit, resurseve dhe pushtetit, të cilat karakterizojnë marrëdhëniet e shërbimeve ndërmjet individëve/bizneseve mikro dhe të vogla në njërin anë dhe bankave/ofruesve të shërbimeve të pagesave në anën tjetër. Në fund, përpjekjet për edukimin financiar të përdoruesve të ri dhe atyre ekzistues, rrisin aftësitë e tyre.

2: Infrastruktura e avancuar dhe ndërvepruese e pagesave dhe rrjetit të pikave të qasjes. Infrastruktura e avancuar e pagesave do të mbështes procesimin e instrumenteve të pagesave relevante. Të gjitha infrastrukturat e pagesave të konsideruara me rëndësi sistemike nga BQK do ju nënshtrohen “Parimeve për infrastrukturën e tregjeve financiare” PFMI të nxjerra nga CPMI-IOSCO. Infrastrukturat tjera financiare, në minimum do të ndjekin praktikat më të mira ndërkombëtare. BQK do të vlerësoj shkallën e rëndësisë sistemike të tyre dhe do të përcaktoj praktikat më të mira të cilave duhet të ju përmbahen ato. Infrastrukturat e pagesave dhe rrjeti i pikave të qasjes do të jenë ndërvepruese me njëra tjetrën, duke rritur kështu efikasitetin dhe duke mundësuar përdorimin e produkteve të pagesave me lehtësi dhe kosto të arsyeshme në të gjithë vendin.

3: Avancimi i kornizës ekzistuese ligjore edhe rregullative dhe adaptimi i instrumenteve të reja ligjore, sipas nevojës. Rregullat jo-diskriminuese të qasjes dhe kushtet e pjesëmarrjes në tregun e ofrimit të shërbimeve të pagesave me vlerë të vogël, do të ruhen dhe avancohen sipas nevojës. Rregullativa e pagesave do të përcjell zhvillimet e tregut në Kosovë dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në linjë me legjislacionin e Bashkimit Evropian – Acquis.

¹ Zhvillimi i një Strategjia Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël “Developing a Comprehensive National Retail Payment Strategy”, World Bank, 2012. <http://documents1.worldbank.org/curated/en/839121469729131991/pdf/84076-REPLACEMENT-FILE-PUBLIC-Developing-comprehensive-national-retail-payments-strategy.pdf>

4: Konkurrencë e fortë, e plotësuar me bashkëpunim. Tregu për ofrimin e shërbimeve të pagesave me vlerë të vogël do të mbrohet nga sjelljet jo-konkurruese dhe abuzimet nga pozitat dominuese, përmes monitorimit të afërt. Në kuadër të industrisë së pagesave, do të kërkohet një balancë adekuate ndërmjet konkurrencës dhe bashkëpunimit. Iniciativat e sektorit privat do të mbështeten deri në arritjen e një force vetë shtytëse për zhvillimin e një Sistemi Kombëtar të Pagesave të sigurt dhe efikas.

5: Qeverisja dhe përgjegjësit për rrezikun. Një kornizë e përshtatshme e menaxhimit të rrezikut do të siguroj që rreziqet dhe kostot e tregut të pagesave me vlerë të vogël të identifikohen dhe menaxhohen në mënyrë adekuate. Do të kërkohet ruajtja e balancës ndërmjet zvogëlimit të rrezikut dhe kostove që e shoqërojnë, duke pasur parasysh se zhvillimet e reja të tregut, herë pas here mund të ndryshojnë ekuilibrin. Në përgjigje ndaj zhvillimeve të reja teknologjike do të përdoret një qasje progresive, por njëkohësisht e kujdesshme. Rregullime të shëndosha dhe efektive të qeverisjes do të mbështesin ofrimin dhe përdorimin e përbashkët të infrastrukturës dhe shërbimeve të saj, nga entitetet e sektorit publik apo atij privat.

6: Mbikëqyrje efektive. Përmes mbikëqyrjes, BQK ka për qëllim ruajtjen e sigurisë së tregut të pagesave me vlerë të vogël dhe sistemit kombëtar të pagesave më gjerësisht, si dhe promovimin e efikasitetit, përballueshmërisë dhe gjithëpërfshirjes së tij. Në ushtrimin e përgjegjësisë të saj të mbikëqyrjes, BQK do të vazhdoj me aplikimin e praktikave më të mira në linjë me parimet dhe standardet e zhvilluara nga komuniteti financiar ndërkombëtar. Si pjesë e aktiviteteve të saj të mbikëqyrjes, BQK do të siguroj një dialog të vazhdueshëm të politikë bërjes me të gjithë akterët relevant të tregut të pagesave me vlerë të vogël. Në rolin e saj të katalizatorit të ndryshimeve, BQK do të adaptoj dhe/ose promovoj masa për lehtësimin e një evoluimi dhe zhvillimi më të shpejtë të tregut të pagesave me vlerë të vogël.

SKPVV përmban një kornizë të detajuar për zgjerimin e qasjes në llogaritë e transaksioneve dhe përsheptimin e rritjes së përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike, e cila përfshin tetë fusha të veprimit:²

- 1. Përkushtim i fuqishëm i të gjithë akterëve.** BQK do të promovoj dhe siguroj përfshirjen më të madhe të mundshme të sektorit publik dhe privat, në vendimmarrjen për interesat e përbashkëta me rëndësi për publikun, lidhur me tregun kombëtar të pagesave me vlerë të vogël. Kjo do të mund të arrihet përmes zgjerimit të anëtarësisë së Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP) nën udhëheqjen e BQK-së.
- 2. Adaptimi i një ambienti rregullativ të përshtatshëm për pagesat digjitale.** Në bashkëpunim të ngushtë me sektorin bankar dhe ofruesit tjerë jo-banka të shërbimeve të pagesave, BQK do të rishikoj kornizën e saj ligjore dhe rregullative për të lehtësuar modele inovative të biznesit dhe për të siguruar mekanizma adekuat për mbrojtjen e konsumatorit. Lidhur me këtë, transpozimi i Direktivës PSD2 do të siguroj neutralitet dhe proporcionalitet në licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve të pagesave, si dhe do të avancoj kornizën për mbrojtjen e konsumatorit. Përveç kësaj, do të iniciohet një rishikim i aplikimit të rregulloreve të PPP/FT me qëllim të përcaktimit nëse aplikimi i kërkesave të obligueshme për njohjen e konsumatorit mund të thjeshtësohen, duke u bazuar në rrezikun që bartin, në mënyrë që të inkurajohet përdorimi i llogarive të transaksioneve dhe pagesave elektronike në përgjithësi. BQK gjithashtu do të rishikoj kornizën e saj të mbikëqyrjes për pajtueshmëri me standardet më të mira ndërkombëtare.

² Aspekti i Pagesave për Përfshirjen Financiare "Payment Aspects of Financial Inclusion", 2016, nga Banka Botërore dhe KITP është përdorë si kornizë bazë. <https://www.bis.org/cpmi/publ/d144.pdf>

3. **Përmirësimi i infrastrukturës së pagesave me vlerë të vogël dhe pagesave tjera digjitale.** BQK do të intensifikoj rolën e saj të katalizatorit për të siguruar vazhdimin e diskutimeve rreth adaptimit të një sistemi ndërbankar të pagesave të shpejta, si dhe të diskutimeve për qasjen e pranuesve të shërbimeve të pagesave apo emetuesve të parave elektronike në sistemin ndërbankar të pagesave, sipas rregullimeve të përshtatshme qeverisëse. BQK do të shqyrtoj të gjitha mundësitë e implementimit të një platforme të pagesave të shpejta përmes së cilës do të mundësoheshin raste të ndryshme të përdorimit. Nga perspektiva e sistemit të pagesave, BQK do të siguroj implementimin e një politike për qasje të drejtë dhe të hapur në infrastrukturën e pagesave, si dhe një mbrojtje efektive nga rreziqet financiare që bartë infrastruktura e pagesave. Shfrytëzimi i plotë i infrastrukturës ekzistuese të kartave të Identifikimit dhe shërbimeve moderne të identifikimit elektronik për aplikimin e kërkesave të njohjes së konsumatorit, do ta lehtësonte zhvillimin dhe digjitalizimin e mëtejshëm të tregut të pagesave me vlerë të vogël.
4. **Instrumente dhe shërbime të pagesave digjitale të përballueshme.** Bankat dhe ofruesit tjerë të shërbimeve të pagesave, si Institucionet Financiare Jo-bankare (IFJB-të) të autorizuar për ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe emetimin e parave elektronike, do të dizajnojnë produkte të përballueshme për klientët që nuk kanë qasje në llogari bankare, të tilla si llogari bazike të pagesave, të cilat do të posedojnë tiparet esenciale të llogarive të transaksioneve që mundësojnë shërbimet bazike të pagesave. BQK ka iniciuar përgatitjen e një rregulloreje për lehtësimin e llogarive bazike. Për më tepër, bankat dhe ofruesit tjerë të shërbimeve të pagesave, do të lehtësojnë interoperabilitetin/ndërveprimin ndërmjet llogarive të ndryshme të pagesave (si psh.: ndërmjet llogarive rrjedhëse në banka dhe llogarive të parave elektronike apo llogarive të pagesave të ofruara nga IFJB-të). BQK do të krijoj një data bazë të çmimeve në kuadër të webfaqes së saj, e cila do të përfshij çmimet e produkteve bankare dhe shërbimeve tjera të pagesave, si një mjet që ju mundëson konsumatorëve një krahasim efektiv të produkteve dhe çmimeve të tyre.
5. **Zgjerimi i rrjetit të pikave të qasjes për shërbimet e pagesave.** Modeli i bankimit përmes agjentëve do të inkurajohet për të rritur qasjen dhe përshtatshmërinë e llogarive të transaksioneve për përdoruesit, përfshirë këtu shfrytëzimin e infrastrukturës së entiteteve të cilat tradicionalisht kanë një prezencë më të gjerë edhe në pjesët rurale dhe komunitetet e izoluara. Ministria e Financave Punës dhe Transfereve do të analizoj aplikimin e mundshëm të stimujve të ndryshëm për tregtarët, bazuar në shembuj të vendeve të BE-së (psh. subvencionimin e përkohshëm fiskal për bizneset e vogla dhe/ose benefite tjera fiskale) për pranimin e pagesave elektronike, përderisa BQK do të siguroj transparencë dhe mbledhjen e të dhënave të tarifave që aplikohen ndaj tregtarëve për shërbimet e pranimit të pagesave elektronike.
6. **Përpjekjet për edukimin financiar.** Objektivi i këtyre përpjekjeve është rritja e vetëdijes së publikut për SKPVV dhe benefitet e saj. BQK, entitetet tjera të sektorit publik, shoqata e bankave të Kosovës dhe ofruesit tjerë të shërbimeve të pagesave do të intensifikojnë përpjekjet e tyre për të edukuar qytetarët e Kosovës lidhur me qasjen dhe përdorimin e llogarive të transaksioneve dhe pagesave elektronike përmes rritjes dhe targetimit të fushatave të informimit. BQK do të vlerësoj, në mënyrë sa më objektive që është e mundur, efektivitetin e përpjekjeve dhe programeve të ndërmarra për edukimin financiar.
7. **Ekonomia e shkallës në SKP përmes shfrytëzimit të rasteve të përdorimit të pagesave me volum të madh.** Veprime specifike përfshirë p.sh. migrimin e të gjitha pagesave të qeverisë, si dhe mbledhjes së të hyrave përmes formave të pagesave elektronike. Përfshirë këtu edhe shfrytëzimin e llogarive bazike të pagesave dhe shërbimeve të ofruara nga IFJB-të dhe kanalet e tyre, përfshirë faturat e shërbimeve komunale dhe pagesat masive në mënyrë që

të kalohet nga pagesat me para të gatshme në pagesat elektronike. Për më tepër, bankat dhe ofruesit tjerë të shërbimeve të pagesave, në bashkëpunim me BQK do të lehtësojnë ofrimin e shërbimeve të llogarive për remitencat për të mundësuar shërbimet jo-kesh, duke rritur konkurrencën dhe nxitur inovacionin në tregun e remitencave në Kosovë.

8. **Mbikëqyrja e tregut të pagesave me vlerë të vogël dhe ofruesve të shërbimeve të pagesave.** BQK do të zgjeroj dhe harmonizoj funksionin e saj të mbikëqyrjes prudenciale dhe mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave, për të siguruar që operatorët e sistemeve të pagesave dhe ofruesit e shërbimeve të pagesave adaptojnë struktura adekuate të qeverisjes dhe menaxhimit të rrezikut kibernetik, rrezikut të mashtrimeve dhe mbrojtjes së konsumatorit, ndër objektivat e saj për të siguruar shërbime të pagesave të sigurta, efikase, me kosto të ulët, dhe të qasëshme për publikun e gjerë.

Implementimi i suksesshëm i strategjisë kërkon caktimin e roleve dhe përgjegjësi specifike për akterët e ndryshëm, sipas rregullave të llogaridhënies publike, si:

- a. SKPVV njih rolin e BQK-së si akterë kritikë në udhëheqjen e përcaktimit të politikave, adaptimit të kornizës rregullative dhe mbështetjen e bashkëpunimit dhe koordinimit në mes të akterëve relevantë për implementimin e strategjisë dhe promovimin e veprimeve të përbashkëta kurdo që është e nevojshme. Ky rol përmbushet nga BQK në kapacitetin e saj si katalizator, rregullator, mbikëqyrës dhe operator i sistemeve të pagesave, si dhe përdorues i shërbimeve të pagesave.
- b. Me anë të SKPVV-së i caktohen disa përgjegjësi edhe Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK), ndër të cilat kordinimin dhe përfaqësimin e interesave të anëtarëve të saj lidhur me çdo çështje që adreson strategjia, si dhe promovimin dhe koordinimin e iniciativave për evoluimin dhe zhvillimin e tregut të pagesave me vlerë të vogël.
- c. Këshilli Kombëtar i Pagesave – KKP, si një organ konsultativ për çështjet që ndërlidhen me sistemin e pagesave, do të përfshihet kryesisht në monitorimin e progresit dhe në përshpejtimin e këtij progresi, si dhe në lehtësimin e komunikimit ndërmjet akterëve të sektorit publik dhe atij privat.
- d. Role dhe përgjegjësi të rëndësishme do të barten edhe nga agjenci tjera qeveritare të cilat bartin përgjegjësi rregullative në fushat që konsiderohen si kritike për fushëveprimin e kësaj strategjie dhe për përdoruesit e këtyre sistemeve.
- e. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të kontribuojnë individualisht në implementimin e Strategjisë përmes përkushtimit ndaj transparencës në ofrimin e shërbimeve të tyre për klientët, menaxhimit të rreziqeve që shoqërojnë shërbimet e pagesave dhe adaptimin e drejtimit strategjik të aprovuar nga BQK.
- f. Operatorët e sistemit të pagesave do të mbështesin objektivat e SKPVV përmes përkushtimit të tyre ndaj interoperabilitetit dhe bashkëpunimit, në pajtim me standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare, si dhe duke ruajtur qasje të drejtë dhe të hapur në infrastrukturën që ofrojnë, përmes adaptimit të drejtimit të aprovuar nga BQK.
- g. Së fundi, shoqatat e ndryshme biznesore dhe organizatat e shoqërisë civile do të angazhohen në çështje specifike, në harmoni me objektivat dhe përgjegjësitë e tyre statutores dhe me kërkesën e KKP, për të mbështetur implementimin e strategjisë.

Monitorimi i progresit në zbatim të SKPVV është kritik në efektivitetin e saj dhe si një input në vlerësimet dhe rishikimet periodike të saj. Për këtë qëllim, janë vendosur dy objektiva kryesore dhe të matshme, si:

- 1. Rritja e numrit aktual të pagesave jo cash deri në 25 pagesa për kokë banori, deri në fund të vitit 2026. Pika fillestare e këtyre pagesave është marr nr.17.3 pagesa pa para të gatshme për kokë banori nga të dhënat e fund vitit 2019.**
- 2. Arritja e zotërimit të së paku një llogarie për pagesa dhe transaksione (llogari bankare, llogari për para elektronike apo llogari të pagesave) në 70% të popullsisë së moshës madhore, deri në fund të vitit 2026. Pika fillestare është 52% e popullsisë së moshës madhore me qasje në llogari bankare sipas të dhënave të fund vitit 2017.**

Gjithashtu, një mori të variablave të ndërmjetme të cilat paraqesin progresin drejt vizionit dhe objektivave të përbashkëta të strategjisë dhe disa nga indikatorët kyç të performancës, do të monitorohen për matjen e progresit në rritjen e qasjes në dhe përdorimit të llogarive të pagesave/transaksioneve. Kjo do të ndihmoj në identifikimin e fushave që kërkojnë ndryshim/korrigjim dhe intervenimin me kohë në adresimin e tyre.

SKPVV do të diskutohet dhe rishikohet në forume dhe takime të ndryshme të akterëve relevant si pjesë e procesit të rritjes së vetëdijes dhe bindjes së tyre për pranimin dhe pronësinë e përgjegjësive të tyre nga ana e akterëve relevant.

I. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI PAGESAT ME VLERË TË VOGËL

Akterët kryesor

1. **Akterët kryesor në tregun e pagesave me vlerë të vogël përfshijnë BQK-në, si autoritet licencues, rregullues dhe mbikëqyrës i institucioneve financiare, Bankat Komerciale, IFJB-të dhe komuniteti i përdoruesve të shërbimeve të pagesave.** Bankat komerciale, IFJB-të, IMF-të, fondet pensionale dhe kompanitë e sigurimeve licencohen dhe mbikëqyren nga BQK.
2. **BQK luan disa role kritike për sa i përket sistemit kombëtar të pagesave, përmes veprimit si operator i sistemit ndërbankar të pagesave, mbikëqyrës i sistemit kombëtar të pagesave dhe katalizator i ndryshimeve.** Si operator i sistemit të pagesave, BQK posedon dhe operon sistemin e vetëm ndërbankar të pagesave (SPN) i cili përbëhet nga dy module, moduli i shlyerjes së pagesave me vlerë të madhe në kohë reale (RTGS) dhe moduli për kliringun e pagesave me vlerë të vogël (ACH). BQK gjithashtu ka në posedim dhe operon me sistemin e letrave me vlerë (CSD), i cili është i integruar me SPN. Këto sisteme/module janë përshkruar më detajisht në vijim.
3. **BQK është e autorizuar me ligj si rregullator dhe mbikëqyrës i sistemit kombëtar të pagesave (neni 8 i Ligjit për BQK dhe neni 8 i Ligjit për Sistemin e Pagesave).** Këto autorizime mbulojnë në mënyrë eksplicite sistemet e shlyerjes së pagesave dhe letrave me vlerë, si dhe shërbimet dhe instrumentet e pagesave. Nga këndvështrimi organizativ, funksioni i mbikëqyrjes së sistemit të pagesave është i ndarë nga funksioni i operacioneve, në kuadër të departamentit të sistemit të pagesave dhe me përgjegjësi të ndara të mbikëqyrjes nga funksionet e BQK-së për licencimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare. BQK është duke punuar në fuqizimin e funksionit të mbikëqyrjes së sistemit të pagesave dhe sinkronizimin e tij me funksionet e licencimit dhe mbikëqyrjes së institucioneve financiare, në mënyrë që rregullimi dhe mbikëqyrja e ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe instrumenteve të pagesave, të mbulohet drejtë (përfshirë modelet e rejtat të pagesave dhe ato të njohura si FinTech), si dhe me qëllim të avancimit të ndërtimit të kapaciteteve të saj në këtë fushë.
4. **BQK kontribuon gjithashtu në zhvillimin dhe reformimin e sistemit kombëtar të pagesave në kapacitetin e saj të katalizatorit të ndryshimeve.** Në këtë rol, BQK inicion, koordinon, kryen studime kërkimore dhe konsulton lidhur me ndërtimin, operimin dhe rregullimin e sistemeve të pagesave, si dhe këshillon Qeverinë në çështje që kanë të bëjnë me sistemin e pagesave, si dhe kontribuon në përgatitjen e propozimeve legjislative në fushën e sistemeve të pagesave.
5. **Këshilli Kombëtar i Pagesave (KKP) është themeluar në vitin 2010.** KKP ka për qëllim mbështetjen e një sistemi të qëndrueshëm dhe efikas të kliringut dhe shlyerjes së pagesave dhe letrave me vlerë. Ky këshill mund të shërbej edhe si një forum i bashkëpunimit për të siguruar kushte të përshtatshme për sistemet regjionale dhe kombëtare të pagesave. BQK është duke rishikuar termat e referencës së funksionit të këtij këshilli duke zgjeruar spektrin e detyrave dhe anëtarëve të tij.
6. **Në Kosovë janë 11 banka dhe degë të bankave të huaja të licencuara dhe 11 IFJB të licencuara për ofrimin e shërbimeve të pagesave, përfshirë Postën e Kosovës.** Bankat komerciale posedojnë rreth 94% të gjithë asetëve financiare dhe janë ofruesit kryesor të shërbimeve të pagesave në Kosovë. Prej 9 IFJB-ve të licencuara për ofrimin e shërbimeve të pagesave, 5 ofrojnë edhe transferet e remitencave ndërkombëtare dhe 4 janë të autorizuar për emetimin e parave elektronike dhe instrumenteve të parave elektronike.

Korniza ligjore dhe rregullative

7. **Baza ligjore për SKP rrjedhë nga Ligji për BQK-në, Ligji për Sistemin e Pagesave dhe Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinancaire dhe Institucionet Financaire Jo-bankare.** Ligji për BQK-në dhe Ligji për Sistemin e Pagesave në mënyrë të qartë e autorizojnë BQK-në si rregullator dhe mbikëqyrës të sistemit kombëtar të pagesave. Në këtë kontekst, BQK nxjerr rregullore, udhëzime, vendime, rregulla operationale, standarde dhe procedura qeverisëse për sistemet e pagesave të cilat i operon, si dhe për aktivitetet e pjesëmarrësve të ndryshëm të SPN-së (psh, bankat, IFJB-të e autorizuarra për ofrimin e shërbimeve të pagesave, operatorët privat të sistemeve të pagesave).
8. **Është në zhvillim e sipër një kornizë ligjore që nxit inovacionin dhe konkurrencën në tregun e pagesave.** Edhe pse Ligji ekzistues për Sistemin e Pagesave përfshinë konceptet e “shërbimeve të pagesave”, “parave elektronike” dhe “institucionet e pagesave”, ende ka nevojë të harmonizohet me Direktivat e BE-së si PSD2, EMD2 dhe Shlyerjen Finale.
9. **Korniza ligjore gjithëpërfshirëse për parandalimin e pastrimit të parave (PPP) / parandalimin e financimit të terrorizmit (PFT) dhe masat për menaxhimin e rrezikut janë plotësuar në 2016.** BQK do të amandamentoj kornizën e saj rregullative me qëllim të ruajtjes së integritetit të sistemit financiar dhe adaptimit të një qasje të bazuar në rrezik, në mënyrë që të eliminoj pengesat e panevojshme për individët dhe bizneset në qasjen dhe përdorimin e shërbimeve financiare të rregulluara mirë.
10. **Bazuar në këto ligje ekzistuese, BQK gjatë periudhës 2019-2020, ka amandamentuar dhe ka nxjerrë disa rregullore të cilat mbulojnë më detajisht një mori të gjerë të aspekteve të sistemeve, instrumenteve dhe shërbimeve të pagesave.** Përveç tjerash, ka amandamentuar Rregulloren për Regjistrimin e IFJB-ve; Rregulloren për sistemin ndërbankar të pagesave, Rregulloren për instrumentet e pagesave elektronike, Rregulloren për PPP/PFT, dhe ka nxjerrë Rregulloren për aktivitetin e emetimit të parave elektronike; Rregulloren për përdorimin e agjentëve dhe nënkontraktimin e shërbimeve nga ofruesit e shërbimeve të pagesave; Rregulloren për licencimin e operatorëve të sistemeve të pagesave; Rregulloren për kapitalin dhe ruajtjen e fondeve të aplikueshme për IFJB-të e autorizuarra për shërbimet e pagesave dhe të parave elektronike.
11. **Aspektet kryesore që ndikojnë në rritjen e shpejtë të posedimit të llogarive për transaksione nga ana e konsumatorëve dhe ofrimin e instrumenteve moderne të pagesave, duhet të adresohen përmes amandamentimit të legjislacionit përfshirë Ligjin për Sistemin e Pagesave.** Temat kritike në këtë fushë përfshijnë mbrojtjen e fondeve të konsumatorëve të cilat i ruajnë në llogaritë e transaksioneve, transparenca lidhur me ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe mekanizmat e mbrojtjes së konsumatorit. Gjithashtu, duhet të cekën disa masa tjera të rëndësishme të cilat janë në fuqi, si skema e sigurimit të depozitave, e cila mbulon të gjitha depozitat në banka deri në shumën 5,000 euro për një depozitor në një bankë dhe Ligji për mbrojtjen e konsumatorit i vitit 2018, i cili mbulon marketingun nga distanca të shërbimeve financiare për konsum dhe kontratat e kredive konsumuese, si dhe Ligji për Sistemin e Pagesave i cili adreson ankesat për shërbimet e pagesave dhe Rregullorja e BQK-së për trajtimin e ankesave për shërbimet e pagesave.
12. **Për të adresuar shumicën e zbrazësive të mbetura, Kosova do të përfitonte përmes përpjekjeve të saj të vazhdueshme në harmonizimin e legjislacionit me direktivat përkatëse të BE-së.³ Disa nga fushat të cilat mund të avancohen sa i përket kornizës ligjore dhe rregullative të pagesave përfshijnë adaptimin e një qasje më konsistente në licencimin,**

³ Kosova ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me Bashkimin Evropian, në fuqi nga data 01 prill 2016.

rregullimin dhe mbikëqyrjen e bankave dhe IFJB-ve dhe zhvillimi i një kornize më të fuqishme për mbrojtjen e përdoruesve të shërbimeve financiare, e cila mbulon shërbimet e reja të pagesave elektronike. Në këtë kontekst, BQK është duke punuar në adaptimin e Direktivës së BE-së për shërbimet e pagesave (PSD2) dhe Direktivës së BE-së për paratë elektronike (EMD) në kuadër të kornizës ligjore dhe rregullative në Kosovë.

Përfshirja financiare në Kosovë nga perspektiva e pagesave

13. **Bazuar në databazën Global Findex, deri në vitin 2017, 52% e të rriturve⁴ kanë poseduar një llogari bankare.** Para janarit 2020, vetëm bankat kanë mundur të hapin llogari për shërbimet e pagesave dhe nuk ka ekzistuar koncepti i llogarive tjera për kryerjen e transaksioneve apo pagesave, si “llogari për transaksione” ose “llogari për pagesa”. Pas janarit 2020, BQK ka nxjerrë rregulloret e reja për emetimin e parasë elektronike. Si rezultat i këtyre rregulloreve, tani edhe IFJB-të e autorizuara për ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe emetimin e parave elektronike, mund të ofrojnë hapjen e llogarive të pagesave dhe llogarive për paratë elektronike për konsumatorët. Aktualisht, ende ka një numër të vogël, por në rritje të llogarive të parave elektronike të ofruara nga institucionet e autorizuar për aktivitetin e parave elektronike në 2020.
14. **Deri në fund të vitit 2019 ka pasur 1,966,286 llogari bankare në posedim nga rezidentët dhe 32,161 nga jo-rezidentë (biznese dhe individ).**⁵ Përderisa vlerësohet se vetëm 941,000 individ posedojnë së paku një llogari me një bankë.⁶
15. **Edhe pse ka pasur një progres nga viti 2014, përqindja e qytetarëve të moshës madhore të cilët kanë poseduar një llogari, në vitin 2017, është jo e favorshme në krahasim me vendet tjera të përafërta në BE apo në regjionin e Azisë Qendrore, si dhe në krahasim me vendet me të ardhura nën mesataren e ulët në nivel botëror .** Tabela 1 paraqet të dhënat e posedimit dhe përdorimit të llogarive në Kosovë në vitin 2017, dhe të dhënat ekuivalente për vendet tjera të regjionit ECA, dhe vendeve me të ardhura nën mesataren e ulët.⁷
16. **Tabela 1 paraqet se përqindja e ulët e poseduesve të llogarive qëndron sidomos në kategorinë e grave, të rinjve dhe të rriturve me banim në zonat rurale.**⁸ Kjo është në harmoni edhe me të dhënat e vendeve me të ardhura nën mesataren e ulët MIC, me një shkallë më të ulët për të rinjtë.⁹ Vlen të theksohet se rreth 125,800 pensionist, që përbëjnë rreth 13% të popullatës të cilët posedojnë një llogari, përdorin llogaritë kryesisht për tërheqjen e parave të gatshme një herë në muajt.¹⁰ Nëse largohet efekti i llogarive të pensionistëve, të dhënat për posedimin e llogarive në Kosovë do të zvogëloheshin në rreth 45%.¹¹

⁴ Moshë 15+.

⁵ Të dhënat e BQK: Prej këtyre llogari bankare të bizneseve resident 153,252 dhe 429 llogari bankare të bizneseve jo-resident.

⁶ Bazuar në Global Findex 2017 dhe në numrin e popullsisë së Kosovës prej 1.8 milion.

⁷ Kosova classifikohet nga Grupi i Bankës Botërore si ekonomi me të ardhura në mesataren e ulët.

⁸ Kjo mund të shpjegohet me faktin se Qeveria e Kosovës ka kanalizuar pagat e të punësuarve përmes sistemit bankar. Përderisa shkalla e papunësisë është më e lartë për kategoritë si gratë, të rinjtë dhe të rriturit në zonat rurale. Prandaj, këto grupe janë paraqitur me posedim më të ulët të llogarive bankare.

⁹ Ka një shkallë të lartë të papunësisë të moshës e re e popullësisë në Kosovë. Shiko paragrafin 36

¹⁰ Bazuar në intervistat me dy bankat.

¹¹ Banka Botërore llogarit bazuar në të dhënat e Global Findex 2017, Popullata e Kosovës (1.8 milion) dhe numri i pensionistëve sipas Statistikave të Mirëqenjes Sociale të 2017 (122,716).

Tabela 1. Të dhëna bazike për posedimin e llogarive

Posedimi i Llogarive (% e popullatës me moshën 15+)	Kosova	ECA	Vendet me të arudhra nën mesatare MIC
Të rriturit, viti 2017	52.3	65.3	57.8
<i>Gratë</i>	43.7	62.5	53.0
<i>Të rriturit në pjesën e 40% më të varfërve</i>	44.3	56.3	50.7
<i>Të rinjtë (% e moshës 15-24)</i>	35.6	50.1	49.4
<i>Të rriturit në zonat rurale</i>	50.2	61.7	57.6
Të rriturit, viti 2014	47.8	57.8	41.9

Burimi: Grupi i Bankës Botërore Databaza e Findex 2017 dhe 2014

- Kosova është duke ndërmarrë disa iniciativa për amandamentimin e kornizës ligjore/rregullative për të ndikuar në rritjen e nivelit të popullatës me përfshirje financiare.** Këto masa përfshijnë: i) Implementimi i Direktivave të BE dhe përgatitjet për zgjerimin e anëtarësisë së Këshillit Kombëtar të Pagesave, si dhe implementimi në proces i portalit elektronik të Qeverisjes (e-Portali).
- Programi 5 vjeçar i edukimit financiar i aprovuar në vitin 2017 nga Bordi Ekzekutiv i BQK.** Si rezultat, janë ndërmarr disa iniciativa për avancimin e edukimit financiar në vend. Këto përpjekje, kryesisht nën udhëheqjen e BQK-së, por edhe të SHBK-së dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (përmes Marrëveshjeve të Bashkëpunimit), përfshirë edhe Javën Globale të Parasë, trajnimet për nxënësit e shkollave elementare, kuizet e ndryshme për nxënësit e shkollave të mesme, ligjëratat e hapura për studentët e universitetit, si dhe materialet dhe broshurat e ndryshme edukative për publikun. Megjithatë, do të ketë fokus më të lartë në produktet dhe shërbimet e pagesave, psh. përmes dedikimit të sesioneve sqaruese të kushteve dhe afateve të shërbimeve/produkteve specifike përmes demonstrimit të funksionimit të tyre në praktikë dhe për transparencën dhe krahasueshmërinë e tarifave që bartin ato.

Infrastruktura financiare në mbështetje të pagesave me vlerë të vogël në Kosovë

- Sa i përket infrastrukturës, Sistemi i Pagesave Ndërbankre (SPN) është sistemi kryesor i pagesave.** BQK ka në pronësi dhe operon me SPN, i cili përmban modulën e shlyerjes së transaksioneve në kohë reale (RTGS) si komponent për pagesat me vlerë të madhe, që në Kosovë përfshijnë të gjitha pagesat mbi 10,000 euro dhe modulën për kliringun automatik (ACH) si komponent për pagesat me vlerë të vogël nën vlerën e caktuar prej 10,000 eurove.¹² SPN fasilton edhe shlyerjen e transaksioneve me letrat me vlerë të qeverisë në tregun primar dhe në tregun sekondar.
- Aktualisht, ka gjithsej 10 banka pjesëmarrëse direkt në SPN (në komponentët e RTGS dhe ACH);** Përveç vet BQK-së, Thesari nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve¹³, Fondi për sigurimin shëndetësor (ende nuk është aktiv) dhe Fondi i Kursimeve

¹² Për më tepër, BQK posedon dhe operon regjistrin e letrave me vlerë (CSD), si sistem për shlyerjen e letrave me vlerë (SSL) nga viti 2011. Ky sistem është i integruar me sistemin e pagesave SPN.

¹³ Nga data 01 maj 2019 është avancuar ndërlidhje Thesarit – Ministria e Financave si pjesëmarrës direkt participant në RTGS.

Pensionale të Kosovës – FKPK janë gjithashtu pjesëmarrës direkt të SPN. Sistemi ndërbankar i pagesave (SPN) përmes rregullores përkatëse (më saktë nenit 12 të saj) parasheh edhe pjesëmarrjen e operatorëve të sistemeve të pagesave të licencuar nga BQK, edhe pse aktualisht nuk ekziston asnjë operator tjetër përveç BQK-së. Institucionet financiare jo-bankare (IFJB-të) nuk janë të përfshira në kuadër të nenit 12 të rregullores për sistemin e pagesave ndërbankare. Komunikimi i mesazheve përmes këtij sistemi është i bazuar në standardin e organizatës ndërkombëtare të standardeve ISO 20022. SPN operon përgjatë orarit të punës duke filluar nga 08:15 deri 15:45 në ditët e punës.

21. **Komponenti ACH i SPN-së operon me tre sesione të kliringut (10:05, 13:35, 15:20) dhe proceson kredit transferet, transaksionet e debitimit direkt, si dhe pagesat individuale dhe ato masive.** Pozicionet net të debitimit të pjesëmarrësve të ACH nuk kolateralizohen në avans, si dhe nuk janë vendosur limite të nivelit të pozicioneve debitore. Në rast të fondeve të pamjaftueshme, bankat kanë qasje në instrumentin e huas brenda ditore që e ofron BQK përmes lënjes së kolateralit në formën e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës.
22. **Aktualisht nuk ekziston ndonjë infrastrukturë kombëtare në formë të SWITCH-it lokal për pagesat vendore (psh. sistem për pagesat e shpejta), i cili do të mundësonte interoperabilitet ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe instrumenteve të ndryshme të pagesave.** Pavarësisht kësaj, të gjithë poseduesit e kartelave të skemave ndërkombëtare si Visa apo MasterCard mund të bëjnë tërheqjen e parave të gatshme nga ATM-të apo të kryjnë pagesa në терминаlet fizike POS dhe ato virtuale e-Commerce, si dhe mbi 95% e kartelave të lëshuara nga bankat lokale janë të skemave Visa dhe MasterCard. Kjo mundësohet pasi të gjitha bankat në Kosovë janë të lidhura me rrjetet globale të procesimit të transaksioneve të këtyre dy skemave ndërkombëtare.

Infrastruktura e ID dhe TIK në Kosovë

23. **Ministria e Puneve të Brendshme, ka filluar me lëshimin e kartave biometrike të identifikimit për qytetarët e saj dhe jo-residentët, të cilët kanë arrit moshën 16 vjeçare.** Karta biometrike e identifikimit kërkohet për shërbime të ndryshme me rëndësi të cilat ofrohen nga agjencitë qeveritare dhe sektori privat (psh. hapja e një llogarie bankare). Deri në vitin 2018 janë lëshuar rreth 1.6 milion karta të identifikimit për qytetarët e Kosovës.
24. **Agjencioni i Regjistrimit Civil (ARC) është autoritet përgjegjës për menaxhimin e sistemit të identifikimit kombëtar dhe të dhënave përkatëse.** Ende nuk janë siguruar lexues fizik të kartave të identifikimit për palët relevante dhe institucionet e interesuara, psh bankat. Njëkohësisht, ARC është duke bashkëpunuar me Agjencionin për Shoqëritë e Informacionit (ASHI lidhur me qasjen në e-Portalin e Qeverisë që është duke u ndërtuar nga ASHI. Lidhur me këtë, do të ishte shumë lehtësuese edhe përgatitja e legjislacionit të nevojshëm për mundësimin e shkëmbimit të informatave personale ndërmjet institucioneve publike dhe atyre private.
25. **Sipas të dhënave të Bankës Botërore deri në vitin 2016, e gjithë popullata që jeton në Kosovë, përfshirë pjesën urbane dhe rurale, në nivelin prej 100% ka pasur qasje në furnizim me elektricitet.** Marr në konsideratë që furnizimi me elektricitet është i mundur nëpër gjithë vendin, sidomos në pjesët më të largëta rurale, qasja në elektricitet nuk konsiderohet si pengesë për konsumatorët apo për ofruesit e shërbimeve të pagesave në Kosovë.

26. Numri i abonentëve të telefonisë mobile ka arritur në rreth 1.97 milion deri në fund të 2018 sipas ARKEP (Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare), gjë që ka rezultuar me një shkallë të penetrimit prej 101%.
27. Sipas Agjencionit të Statistikave të Kosovës, deri në fund të 2018, 93.2% e individëve në Kosovë kanë pasur qasje në internet. Një përqindje kjo më e lartë se vendet e rajonit përfshirë Shqipërinë (63%), Bosne dhe Hercegovinën (65%), Malin e Zi (65%), dhe Serbinë (64%).

Instrumentet e pagesave me vlerë të vogël të përdorura në Kosovë

28. Instrumentet e pagesave me vlerë të vogël përkufizohen si instrumente të cilat lehtësojnë transferin e fondeve si parave të gatshme, debit dhe kredit kartelat, transferet e kreditit, debitimi direkt dhe instrumente tjera inovative të pagesave, si para elektronike. Pagesat me vlerë të vogël mund të iniciohen me prezencë fizike apo nga distanca. Përdoruesit e instrumenteve të pagesave me vlerë të vogël mund të kategorizohen gjerësisht në konsumatorë, biznese, agjencione qeveritare. Të gjithë kanë rolë të dyfishtë, duke qenë si pagues për disa transaksione dhe të paguar për disa tjera. Varësisht nga kombinimi i paguesit me të paguarin, pagesat me vlerë të vogël mund të karakterizohen në lloje të ndryshme. Kombinimet e mundshme janë paraqitur në Tabelën 2 më poshtë.

Tabela 2. Llojet e ndryshme të pagesave, bazuar në kombinimin pagues – i paguar

I paguar Pagues	Konsumator	Biznes	Institucion Qeveritar
Konsumator	P2P	P2B	P2G
Biznes	B2P	B2B	B2G
Institucion Qeveritar	G2P	G2B	G2G

P=Person - Individ, B=Business - Biznesi, G=Government - Qeveria




Burimi: Banka Botërore (2015), "Udhëzues praktik për matjen e kostos së pagesave me vlerë të vogël".

Paraja e gatshme (Cash)

29. Në Kosovë dominojnë pagesat me para të gatshme, sidomos pagesat me vlerë të vogël. Volumi i tërheqjeve përgjatë kohës paraqet një përdorim të lartë të cash-it në vend.¹⁴
30. Jo rasisht edhe ATM-të përdoren kryesisht për tërheqjen e parave të gatshme. Pjesa e tërheqjeve nga ATM është rritur nga 67% në periudhën 2015-2016 në 76% përgjatë 2016-2017. Njëkohësisht, tërheqjet e cash përmes institucioneve financiare jo-bankare (IFJB-ve) kanë qëndruar përafërisht në nivel të njëjtë, përderisa tërheqjet fizikisht përmes degëve të bankave kanë pësuar rënie. Pavarësisht nga ndarja konstante e transaksioneve të tërheqjes së cash ndërmjet bankave dhe IFJB-ve, volumi i tërheqjeve përmes IFJB-ve, për periudhën e njëjtë kohore, ka shënuar një rritje.

¹⁴ Të dhënat e marra nga Studimi i Bankës Botërore i realizuar në Kosovë mbi përdorimin dhe koston e instrumenteve të pagesave me vlerë të vogël nga ana e ofertës.

Paraqitja grafike: Volumi i tërheqjeve të cash përgjatë një periudhe tre vjeçare

**Instrumentet e pagesave jo-cash (pa para të gatshme)**

31. Përdorimi i instrumenteve të pagesave pa para të gatshme në Kosovë, përveç transaksioneve për tërheqjen e cash, është ende i ulët në krahasim me vendet tjera të rajonit, me përjashtim të Shqipërisë. Numri total i pagesave elektronike (jo-cash) të kryera nga qytetarët e Kosovës ishte 17.3 në vitin 2019, që është më lartë në krahasim me vendet me të ardhura të ulëta MIC (4.2 sipas të dhënave nga GPSS për vitin 2016). Në krahasim me rajonin, në vitin 2016 Shqipëria raportoi 4.3 transaksione jo-cash për kokë banori.

Në vitin 2015 Mali i zi dhe Sërbia raportuan 26 përkatësisht 62 transaksione jo-cash për kokë banori. Përderisa, vendet me të ardhura të larta, raportojnë rreth 250 transaksione jo-cash për kokë banori në baza vjetore.

32. **Kartelat e pagesave janë instrumenti më i përdorur jo-cash, i cili pësoi një rritje rreth 50% përgjatë periudhës 2015-2019.** Tabela 3 paraqet të dhënat mbi përdorimin e instrumenteve të ndryshme të disponueshme në Kosovë. Ende ka hapësirë për rritjen e pagesave me kartela, nëse merret në konsideratë se vetëm 37% e qytetarëve të moshës madhore në Kosovo¹⁵ posedojnë një kartelë debiti (në krahasim me rreth 51% të vendeve të ECA), si dhe faktin që ato ende përdoren kryesisht vetëm për tërheqjen e cash nga ATM.
33. **Duke filluar nga 2018, përdorimi i transfereve të kreditit të bazuara në letër, të iniciuara në formë fizike, ka rënë në Kosovë.** Përveç pagesave me kartelë, janë rritur edhe transferet e kreditit të iniciuara përmes kanaleve elektronike, të cilat hyjnë në pagesat tërësisht elektronike.¹⁶ Transaksionet e Debitimit Direkt kanë pësuar një rënie domethënëse në vitin 2018, për arsye se pjesëmarrësi kryesor “KESCO” ka dalur nga skema e debitimit direkt. Në anën tjetër kishte një rritje të transfereve elektronike të kreditit për 18%. Pastaj, shërbimet e bankingut online janë ofruar nga shumica e bankave. Megjithatë, penetrimi i këtyre shërbimeve është ende i ulët. Deri në fund të vitit 2019 vetëm rreth 303,602 nga të gjitha llogaritë e mbajtura nga individët, kanë pasur qasje përmes bankingut online.
34. **Pagesat përmes instrumenteve të parasë elektronike.** Në janar 2020 kanë hyrë në fuqi rregulloret e reja të bazuara në Direktivën e BE-së për emetimin e parasë elektronike, të cilat përveç bankave, mundësojnë emetimin e parave elektronike edhe nga IFJB-të. Aktualisht, ka një IFJB të re e cila është regjistruar për emetimin e parave elektronike dhe tri IFJB ekzistuese të cilat përveç shërbimeve të pagesave janë autorizuar edhe për emetimin e parave elektronike. Kjo sjell në katër, numrin e IFJB-ve të regjistruara për ofrimin e shërbimeve të parave elektronike, të cilat janë autorizuar gjatë vitit 2020.

Tabela 3. Numri i transaksioneve të iniciuara nga konsumatorët (individët dhe bizneset)

Përshkrimi	2015	2016	2017	2018	2019
1. Transferet e kreditit në formë letre	13,731,800	15,440,364	15,246,593	12,346,739	12,680,625
2. Transferet elektronike të kreditit	2,311,564	2,915,082	3,407,660	4,391,441	5,199,787
3. Pagesat me kartel	5,471,659	6,811,339	7,610,989	10,631,516	13,266,708
4. Debitimi direkt (brenda bankës)	15,565	26,610	23,151	2,738	1,037
5. Pagesat me para elektronike	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
6. Çeqet	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Totali i pagesave jo-cash	21,530,588	25,193,395	26,288,393	27,372,434	31,148,157
Pagesat jo-cash për kokë banori	11.96	14	14.6	15.21	17.3

Burimi: GPSS 2017 dhe BQK

35. **Kosova ende ka një përdorim të ulët të instrumenteve të pagesave jo-cash. Përveç përqindjes së ulët të personave në moshë madhore që posedojnë llogari, një faktor**

¹⁵ Anketa e Global Findex 2017.

¹⁶ Instrumentet e pagesave elektronike përdorin forma elektronike për iniciimin, autorizimin dhe autentifikimin e një transaksioni pagese. Megjithatë, edhe pse një transaksion mund të iniciohet në formë elektronike, në disa raste procesi i mëtejshëm i kliringut dhe shlyerjes mund të kenë nevojë për disa procedura manuale.

tjetër kontribues është edhe mungesa e produkteve të ndryshme të pagesave elektronike në vend. Për më tepër, shkalla e lartë e papunësisë (29.6%¹⁷) sidomos në moshat e reja¹⁸ (55.4%), niveli i lartë i informalitetit në ekonomi dhe punësim¹⁹ dhe nivelet e ulëta të edukimit,²⁰ shihen si disa nga faktorët tjerë kontribues. Një përqindje më e lartë e posedimit të llogarive do të rriste edhe përdorimin e instrumenteve të pagesave jo-cash, edhe pse jo çdo herë. Mbajtësit e një llogarie mund të vendosin të mos përdorin opsionet e pagesave jo me para fizike nga llogaritë e tyre, thjesht për arsyen se ato nuk i përmbushin nevojat e tyre. Kutia informuese nr.1 në vijim ofron një përmbledhje të faktorëve që influencojnë zotërimin e instrumenteve të ndryshme të pagesave me vlerë të vogël (përfshirë paranë fizike), në bazë të përvojës së Bankës Botërore. Këta faktorë lidhen si me konceptimin thelbësor të instrumenteve të pagesave ashtu edhe me elementet apo veçoritë që ofruesi i shërbimit të pagesave vendos ti përfshijë në produktin e pagesave, nëpërmjet të cilit ai instrument përdoret. Nga ana tjetër, nivelet e larta të informalitetit në ekonomi dhe në tregun e punës apo shkalla e lartë e papunësisë do të ndikojnë në ruajtjen e një niveli të ulët të personave të moshës madhore që posedojnë dhe që të përdorin rregullisht një llogari, si dhe që të preferojnë përdorimin e parasë së gatshme.

Kuti informuese 1. Faktorët që ndikojnë në përdorimin e instrumenteve të pagesave me vlerë të vogël

Përdorimi i çdo instrumenti të caktuar pagesash me vlerë të vogël nga konsumatorët, bizneset dhe qeveria, ndikohet nga fakti se sa përshtatet ky instrument me nevojat specifike të paguesit dhe të paguarit, si dhe me faktin se si secili prej tyre percepton instrumentin lidhur me rrezikun, likuiditetin, koston, pranimin dhe lehtësinë. Për një pagues, zgjedhja e instrumenteve të pagesave ndikohet në mënyrë thelbësore nga faktorët e mëposhtëm:

- **Kostoja:** Përdorimi i instrumenteve të pagesave përfshin si kostot eksplicite dhe ato implicite. Kostot eksplicite përfshijnë tarifa të drejtpërdrejta të paguara nga paguesi për përdorimin e instrumentit, të tilla si tarifa për transaksion. Kostot implicite, përfshijnë, për shembull, kohën në pritje për procesimin e një kërkesë pagese ose koston e kohës së shpenzuar në udhëtim deri në vendin ku mund të merren paratë e gatshme për të kryer pagesa, ose ku mund të përdoret instrumenti i pagesave elektronike (jo-cash).
- **Siguria dhe besueshmëria:** Paguesi ka nevojë për një nivel të lartë besimi se instrumenti i pagesës do të funksionojë sikurse pritjet dhe do të shlyejë detyrimin e pagesës, ashtu siç është kërkuar. Kjo përfshin, ndër të tjera, aspekte që lidhen me kohën gjatë së cilës sistemi është i disponueshëm, keqpërdorimet për qëllime mashtrimi, korrigjimin e gabimeve në përpunimin e kërkesës së procesimit dhe të tjera.
- **Përshtatshmëria:** Instrumenti i pagesave duhet të jetë i përshtatshëm për t'u përdorur. Kjo përfshin aspekte të tilla si: çfarë duhet të mbaj në mend paguesi; ose se çfarë duhet të mbajë fizikisht për të kryer një pagesë; sa kohë duhet që të kryhet transaksioni kur përdoret instrumenti në fjalë; dhe aspekte të tjera të lidhura me të.
- **Pranimi:** Një pagues do të dëshirojë që instrumenti i pagesës të pranohet gjerësisht për kryerjen e pagesave të tij. Për shembull, një zotërues kartele për pagesë mund të mos e shohë dobinë e kartës nëse ajo nuk pranohet në vende si dyqanet ushqimore dhe restorantet, apo nuk mund të përdoret për pagesat e shërbimeve utilitare dhe për pagesat tjera që përbëjnë një pjesë të rëndësishme të pagesave të tij rutinore.

¹⁷ ASK, të dhënat për 2018.

¹⁸ ASK të dhënat për moshat 15-24

¹⁹ Grupi i Bankës Botërore "Country partnership framework for Republic of Kosovo for the period FY17–FY21"

²⁰ Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) të dhënat për vitin 2015, 38.1% e të punësuarve të moshës madhore kanë të përfunduar klasën I-IX, 26.9 shkollën e mesme profesionale dhe 20.1 gjimnazin e mesëm. Vetëm 12.6% e të punësuarve kanë të përfunduar shkollimin e lartë.

- **Konfirmimi dhe shlyerja e pagesës:** Një pagues do të dëshirojë një konfirmim për iniciimin dhe procesimin e pagesës së tij sipas kohës së caktuar. Kjo do të shërbejë si regjistrim për barazim dhe si provë që pagesa është kryer. Kjo do ta ndihmojë paguesin të administrojë dhe të monitorojë llogarinë e tij të pagesave.

Për të paguarin, faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e instrumenteve të pagesave janë të ngjashëm me ato të përmendura më lartë, por kanë disa dallime të rëndësishme:

- **Kostoja:** Përfituesi i pagesës has në kosto implicite dhe eksplicite të ndryshme kur pranon një instrument pagese. Paraja e gatshme, për shembull, ka kosto mbajtjeje, transporti dhe ruajtjeje. Një kosto implicite e rëndësishme është koha që shpenzohet për kalimin e fondeve në llogarinë e marrësit. Sa më e gjatë vonesa, aq më e lartë është, ndër të tjera, kostoja e interesit të munguar dhe/ose kostoja për administrimin e likuiditetit.
- **Pranimi:** Në përgjithësi, përfituesi i pagesës, pranon ato instrumente pagesash që preferohen nga një pjesë sa më e madhe paguesish. Disa instrumente të pagesave, kërkojnë që marrësi i pagesës të ketë një llogari të depozitave me bankën apo me ndonjë ofrues tjetër të shërbimit të pagesave. Për më tepër, për disa instrumente i paguari duhet të posedojë infrastruktur të caktuar, si terminale POS dhe mjete të tjera të telekomunikimit.
- **Siguria dhe besueshmëria:** I paguari duhet të ketë besim se instrumenti i pagesës që ai ka pranuar do të procedohet ashtu si pritet dhe pagesa do të kryhet. Kjo përfshin aspekte të tilla si koha e sigurt e procesimit, koha e funksionimit të sistemit, mosrefuzim i pagesës dhe përfundimi i shlyerjes.
- **Shlyerja e pagesës dhe gjurmët për auditim:** Një përfitues pagese ka nevojë për informacion për regjistrimin e pagesës për të mundësuar kontimin e rregullt. Gjurmët e kontrollit të pagesës janë gjithashtu të rëndësishme, edhe kur, për shembull duhet të mbrohen pretendime që lidhen me kërkesën për refuzimin e pagesës.

Burimi: Banka Botërore, 2012, "Zhvillimi i një strategjie gjithëpërfshirëse kombëtare të pagesave me vlerë të vogël"

Qeveria si përdoruese e shërbimeve të pagesave

36. **Disbursimet në masë të sektorit publik, në mënyrë thelbësore, përfshijnë pagesat të rregullta të benefiteve sociale dhe granteve, pagat, pensionet dhe pagesat dhe kontributet tjera të sigurimeve shoqërore.** Sektori publik në Kosovë punëson më tepër se 83,000 persona.²¹ Pagat dhe kompensimet tjera, në nivelin e qeverisjes qendrore dhe në nivelin komunal, janë të gjitha të paguara përmes llogarive bankare të përfituesve.
37. **Bazuar në Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, departamenti i pensioneve në Ministrinë për Punë dhe Mirëqenje Sociale në Kosovë, është përgjegjës për administrimin e skemave pensionale.** Sipas ligjit, të gjitha pensionet duhet të shpërndahen në llogaritë bankare të pensionistëve. Departamenti i Mirëqenies Sociale në kuadër të Ministrisë administron disa programe të asistencës sociale, të cilat gjithashtu, sipas ligjit, duhet të shpërndahen në llogaritë bankare të përfituesve.
38. **Mbledhja e të hyrave nga niveli qendror i qeverisë, doganat dhe kontributet tjera të sigurimit shoqëror, si dhe kontributet për sigurimin shëndetësor, mbledhen përmes bankave.** Të gjitha pagesat për agjencitë e ndryshme qeveritare, mbi shumën prej 10 eurove, paguhen dhe procesohen përmes bankave. Nga maj i vitit 2019 Thesari-Ministria e Financave Punës dhe Transfereve është kyçur si pjesëmarrës direkt i SPN-së, duke zvogëluar kështu rrezikun operacional të shoqëruar me urdhërpagesat në formë të letrës fizike dhe duke rritur efektivitetin dhe efikasitetin e pagesave të Thesarit.

²¹ Ministria e Financave – Raporti Vjetor Financiar për Buxhet: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/B4CA39B5-EC06-48D0-90D1-3A73D40D7772.pdf>

39. **Qeveria e Kosovës, përmes Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit, nën Ministrinë e Administratës Publike, është duke udhëhequr një projekt mbi qeverisjen elektronike (e-Portali).** Qëllimi i këtij projekti është të ju siguroj qytetarëve të Kosovës qasje nga distanca (online) në disa shërbime publike dhe të ju mundësoj atyre pagesën për këto shërbime në formë digjitale përmes e-commerce. Autoritetet e qeverisë dhe sektorit privat janë angazhuar përmes takimeve të nivelit teknik dhe diskutimeve për të operacionalizuar këtë platformë të qeverisjes elektronike. Si rezultat i kësaj, pjesa e parë e këtij projekti, që lidhet me centralizimin e shërbimeve publike dhe informimin e qytetarëve përmes platformës është pothuajse e gatshme. Megjithatë, ende nevojiten zhvillime të mëtejme për të përfshirë edhe mundësinë e pagesës së shërbimeve, në mënyrë që qytetarët të mund të ju qasen shërbimeve që ju nevojiten përmes përdorimit të kredencialeve të autentifikimit që përmban karta e identitetit dhe të mund të paguajnë për ato shërbime në formë digjitale (përmes e-commerce apo bankingut online) në rastet kur ato shërbime ofrohen me pagesë.

Pikat dhe kanalet e qasjes në shërbimet e pagesave në Kosovë

Degët e bankave dhe agjentët

40. **Në përgjithësi, infrastruktura banakare është e koncentruar në kryeqytet dhe qytetet e mëdha.** Deri në vitin 2017, numri i degëve të bankave për 100,000 banor të moshës madhore është zvogëluar në 16.8 në krahasim me 20.6 sa ka qenë në vitin 2015. Siç shihet në Tabelën 4 më poshtë, ky tregues është më i ulëti në mesin e vendeve fqinjë.

Tabela 4. Numri i degëve të bankave për 100,000 banor – Vendet e Ballkanti Perendimor (2017)

Vendi	Numri i degëve për 100,000 të rritur
Mali i zi	43.6
Bosnia dhe Hercegovina	28.3
Serbia	28.2
Maqedonia Veriore	25.6
Shqipëria	20.6
Kosova	16.7

Burimi: Anketa për Qasje në Financa, Fondi Monetar Ndërkombëtar, 2017

41. **Modeli i bankingut përmes agjentëve nuk është zhvilluar shumë në Kosovë.** Shifrat e sipërme paraqesin një zvogëlim të numrit të degëve nga ana e bankave. Edhe pse Ligji për Sistemin e Pagesave përmes nenit 13, lejon bankat që të përdorin agjentët, kjo mundësi nuk është shfrytëzuar mjaftueshëm në praktikë. Për të rregulluar më detajisht këtë aktivitet, në janar të vitit 2020 BQK ka nxjerr një rregullore të re mbi agjentët dhe nënkontraktimin e aktiviteteve nga ana e ofruesve të shërbimeve të pagesave. Pritet që këto mundësi të përdoren nga ana e bankave dhe IFJB-ve të autorizuara për shërbimet e pagesave dhe emetimin e parave elektronike, marr parasysh se ato kanë shfaqur interesim në favor të modelit të bankingut të bazuar në agjentë për disa kategori të klientëve, siç janë psh përfituesit e asistencës sociale.

ATM-të dhe Terminalet POS

42. **Infrastruktura e ATM-ve dhe POS-ve nuk është zhvilluar mjaftueshëm në Kosovë, krahasuar me vendet tjera të rajonit.** Numri i ATM-ve për 100,000 të rritur është 35.3,

ndër më të ulëtët në rajon. Përderisa numri i terminaleve POS për 100,000 të rritur është 642, prapë në nivelin më të ulët në krahasim me rajonin, me përjashtim të Shqipërisë.

Tabela 5. Numri i ATM-ve dhe POS-ve për 100,000 të rritur – Vendet e Ballkanit Perendimor (2018)

Vendi	Numri i ATM/100,000 të rritur	Numri i POS/100,000 të rritur
Montenegro	87.0	1,962
Republic of North Macedonia	59.8	1,545
Bosnia and Herzegovina	55.8	761
Serbia	48.4	1,038
Kosovo	35.3	642
Albania	30.6	254

Burimi: Anketa për Qasje në Financa, FMN, 2018; të dhënat e BQK për 2018 dhe llogaritjet e Bankës Botërore.

43. **Krahasuar me vitin 2015, në vitin 2018 numri i ATM-ve për 100,000 të rritur është zvogëluar nga rreth 40 në 35.3 përderisa numri i terminaleve POS për 100,000 të rritur është rritur nga 540 në 642.** ATM-të përdoren kryesisht për tërheqjen e cash-it, ku vetëm rreth 15% të numrit total të ATM-ve ofrojnë shërbimin e transferimit të fondeve. Terminalet POS përdoren kryesisht për pagesat me kartela në pikat e shitjes së tregtarëve, edhe pse së fundi disa nga bankat kanë filluar me ofrimin e shërbimit të tërheqjes së cash në pikat e shitjes. Tabela 6 paraqet disa nga të dhënat bazike për ATM-të dhe terminalet POS në Kosovë.

Tabela 6. ATM-të dhe Terminalet POS në Kosovë (2019)

Automated Teller Machines (ATM), nga të cilët:	497
ATM me funksionin e tërheqjes	497
ATM me funksionin e transfereve të kreditit	51
ATM me funksionin e deponimit	244
Terminalet POS (Point of Sale), nga të cilët:	13,769
Terminale POS me funksion të tërheqjes	87
EFTPOS terminals	13,682
Terminalet POS Virtual	N/A
Terminalet për Para Elektronike	16

Burimi: BQK, Dhjetor 2019

44. **Shpërndarja gjeografike e ATM-ve dhe terminaleve POS është ende e kufizuar.** Në fakt, deri në fund të vitit 2019 rreth 34.6% e ATM-ve dhe 41.5% e terminaleve POS ishin të koncentruara në rajonin e Prishtinës, një dallim i madh me komunat tjera.²² Mbulueshmëria kufizohet edhe më tej për faktin se ka një ndërveprim të kufizuar midis kanaleve të ndryshme të qasjes.

²² Përdorimi i kartelave në Kosovë, Gusht 2019 - BQK.

Kanalet tjera të ofrimit të shërbimeve të pagesave

45. **Posta e Kosovës është e licencuar nga BQK për ofrimin e shërbimeve të pagesave.** Ajo ka një rrjet prej 120 degëve ku përveç shërbimeve postare ofron edhe shërbimet e pagesave me para të gatshme si pagesat për qeverinë, shërbimet komunale, sigurimin e veturave, si dhe transferimin e parave si agjentë i Western Union përmes IFJB UFP. Duke filluar nga 2017, Posta e Kosovës ka nënshkruar marrëveshje me Ministrinë për Punë dhe Mirëqenje Sociale dhe me bankën BPB për të marr përsipër shpërndarjen e asistencës sociale për qytetarët, në rolin e agjentit të bankës. Për arsye të rrjetit të saj dhe prezencës në vende më rurale, kanë shpreh interesim për të rritur numrin e shërbimeve të pagesave, si psh për shpërndarjen edhe të pensioneve dhe skemave tjera sociale për qytetarët që jetojnë më larg qyteteve të mëdha.
46. **Rrjetet tjera janë edhe katër IFJB-të si ofruesit më të mëdhej të shërbimit të remitencave në Kosovë.** Në total këto katër IFJB kanë një rrjet prej 341 pikave nëpër gjithë vendin. Western Union përmes super-agjentit të tij lokal Unioni Financiar Prishtinë dhe MoneyGram përmes super-agjentit lokal Moneta përbëjnë rreth 85% të tregut të remitencave. Pjesa tjetër mbulohet nga Ria International përmes dy agjentëve lokal, IFJB Vllesë dhe IFJB Capital. Të gjitha kontratat që kanë super agjentët me agjentët e tyre përmbajnë dispozitat e ekskluzivitetit. Kjo më herët ka qenë kërkesë rregullative e BQK-së deri në janar të vitit 2020, kur ka hyrë në fuqi rregullorja e re për agjentët e cila e ndalon ekskluzivitetin në kontratat me agjentët. Në Kosovë ka edhe tre ofrues tjerë të shërbimeve të remitencave, si Small World e cila operon përmes IFJB Vllesë dhe UPT e cila operon me bankën BKT, KLM e cila ofron vetëm shërbimin e remitencave për transferet hyrëse, si dhe IFJB Paysera e licencuar gjatë vitit 2020 si institucion për lëshimin e parave elektronike, e cila mundëson pranimin dhe dërgimin e transfereve përmes skemës SEPA.

VIZIONI DHE STRATEGJIA PËR ZHVILLIMIN E NJË SISTEMI TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL NË KOSOVË

Vizioni ynë

Krijimi i një tregu modern dhe gjithëpërfshirës të pagesave me vlerë të vogël në Kosovë, të mbështetur me infrastrukturë të sigurtë dhe efikase të pagesave, si dhe me një gamë të gjerë të instrumenteve dhe shërbimeve të pagesave të cilat i plotësojnë nevojat e përdoruesve të shërbimeve të pagesave në të gjithë vendin.

Qëllimi ynë

Të sigurohemi që tregu i pagesave me vlerë të vogël ju ofron përdoruesve të pagesave më shumë zgjidhje, në sa më shume vende për kryerjen e transaksioneve të tyre të përditshme, në mënyra më të përshtatshme dhe me kosto efektive, në mbështetje edhe të objektivit të rritjes dhe zgjerimit të përfshirjes financiare.

47. **Objektivi kryesor i SKPVV-së do të jetë nxitja e përdorimit të instrumenteve moderne (psh plotësisht elektronike) të pagesave me vlerë të vogël në të gjithë vendin, me qëllim të arritjes së 25 pagesave jo-cash për kokë banori, deri në fund të vitit 2026.**²³ Ky objektivi do të çonte në dyfishimin e normës së rritjes së përdorimit të pagesave jo-cash përgjatë pesë viteve të ardhshme, nga rritja e periudhës 2014-2018. Prandaj, objektivi i arritjes së 25 pagesave jo-cash për kokë banori deri në fund të vitit 2026, konsiderohet ambiciozë, por i arsyeshëm.
48. **Zgjerimi i mundësive për qasje në llogari të transaksioneve është një kusht i domosdoshëm për të arritur objektivin kryesor.** Në lidhje me këtë, Kosova synon të arrijë një nivel të zotërimit të llogarive nga personat e moshës madhore, prej 70% deri në fund të vitit 2026. Kosova ka pasur një rritje prej 4% për çdo tre vite, të zotërimit të llogarive nga qytetarët e moshës madhore. Përderisa në vendet me të ardhura mesatare ka një rritje mesatare prej 14%. Prandaj, me supozimin që do të ketë një rritje prej 9% çdo tre vite, arsyetohet objektivi kryesor që të arrihet një raport prej 70% të qytetarëve të moshës madhore të kenë së paku një llogari të transaksioneve (viti fillestar 2017).

²³ Nga baza e këtij indikatorit prej 15.2 pagesa jo-cash për kokë banori në fund të vitit 2018.

49. **Zbatimi i SKPVV-së ka për qëllim jo vetëm rritjen e niveleve të zotërimit dhe përdorimit të llogarive, por edhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të pagesave për konsumatorët.** Zbatimi i suksesshëm i SKPVV-së do ju sjellë përfitime klientëve ekzistues dhe të rinjë, nëpërmjet:
- (i) Rritjes së shpejtësisë me të cilën pagesat iniciohen, procesohen dhe shlyhen;
 - (ii) Rritjes së besueshmërisë dhe kohës së disponueshmërisë së pagesave që kryhen përmes infrastrukturës vendore dhe përmes kanaleve për shpërndarjen dhe pranimin e pagesave të cilat përkrahin edhe pagesat me vlerë të vogël;
 - (iii) Rritjes së përshtatshmërisë për përdoruesit duke rritur mundësitë për të paguar në mënyrë elektronike, nga distanca ose në sportel;
 - (iv) Ofrimit të shërbimeve të pagesave gjithnjë e më të përballueshme për individët, bizneset dhe qeverinë, duke promovuar përmirësime të infrastrukturës (financiare dhe zgjerimit të pranimit të pagesave) dhe duke nxitur rritjen e konkurrencës dhe inovacionit në ofrimin e shërbimeve të pagesave.

II.1. Parimet udhëzuese

50. **SKPVV-ja duhet të zbatohet me rigorozitet.** Pas miratimit, SKPVV-ja do të zbatohet sipas një afati kohor rigoroz. Në varësi të ecurisë së zbatimit, besueshmëria e të gjitha institucioneve të përfshira në këtë strategji do të vendoset përball publikut Kosovar. Progresi do të monitorohet në bazë të një numri treguesish të performancës, të cilët do të shtjellohen më hollësisht në Pjesën V.2 të kësaj strategjie. Mekanizmat transparent të llogaridhënies do të sigurojnë që secili pjesëmarrës të përgjigjet për performancën e tij lidhur me progresin e zbatimit.
51. **Zbatimi i SKPVV-së do të bazohet në gjashtë parime udhëzuese.** Këto parime do të mbështesin veprimet e BQK-së, agjencive qeveritare, bankave, ofruesve të shërbimeve të pagesave jo-banka dhe të gjithë akterëve tjerë relevant, në përmbushjen e përgjegjësisë të tyre ndaj SKPVV-së. Parimet udhëzuese në thelb ndjekin Udhëzimet e Grupit të Bankës Botërore për Zhvillimin e një Strategjia Gjithëpërfshirëse Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël, të listuara në vijim:

Parimi udhëzues 1: Transparenca, paanshmëria dhe mbrojtja e përdoruesve

52. **Transparenca është tejet e rëndësishme për rritjen e konkurrencës dhe forcimin e mbrojtjes së përdoruesve të pagesave me vlerë të vogël.** Funksionimi në mënyrë sa më transparente i tregut të pagesave me vlerë të vogël do të zvogëlonte stimujt e sjelljeve abuzive nga ofruesit individual të shërbimeve të pagesave dhe operatorët. Një aspekt kyç i transparencës lidhet me shpalosjen e çmimeve për shërbimet/produktet e ndryshme të pagesave të ofruara sipas një metodologjie e cila mundëson krahasimin efektiv të çmimeve, së bashku me kushtet dhe afatet tjera përkatëse.
53. **Paanshmëria në tregun e brendshëm të pagesave me vlerë të vogël do të promovohet për të siguruar që pjesëmarrësitë ndajnë perceptimin e përbashkët se interesat dhe nevojat e tyre individuale merren në konsideratë dhe adresohen në mënyrë të drejtë nga rregullatorët, mbikëqyrësit dhe operatorët e sistemeve të pagesave dhe të rrjeteve të pikave të qasjes.** Paanshmëria ka të bëjë me trajtimin e barabartë të bankave dhe IFJB-ve të autorizuara për ofrimin e shërbimeve të pagesave, duke përfshirë zbatimin e

kritereve jo-diskriminuese të bazuara në rrezik për pjesëmarrje në sistemet ndërbankare të pagesave dhe rrjetet tjera të pagesave me vlerë të vogël. Gjithashtu, ajo i referohet përdorimit të sanksioneve efektive për penalizimin e sjelljeve abuzive dhe keqpërdoruese të tregut. Për përforsimin e këtij perceptimi do të ndihmoj dialogu i vazhdueshëm i BQK-së me pjesëmarrësit dhe akterët tjerë relevant, lidhur me zhvillimet në fushën e pagesave. Hapi i parë në këtë drejtim është kryer nëpërmjet përfshirjes së akterëve të tregut në diskutimin dhe përgatitjen e kësaj SKPVV-je.

54. **Informacioni për qëllime edukimi do të targetoj përdoruesit e rinj, si dhe rritjen e njohurive rreth shërbimeve financiare për përdoruesit ekzistues, përfshirë përfituesit e remitencave.** Përpjekjet për edukim dhe transparencë ndihmojnë në nxitjen e konkurrencës efektive dhe përforsimin e disiplinës së tregut, duke lehtësuar qasjen në informacionin relevant për përdoruesit ekzistues dhe të rinj. Vetëdijësimi për tiparet e instrumenteve moderne të pagesave dhe mënyrën se si ato mund të ndihmojnë individët dhe bizneset në përmbushjen e nevojave të tyre të pagesave, do të rritet si për përdoruesit ekzistues edhe ata të rinj, me fokus të veçantë ndaj përdoruesve të rinj marrë në konsideratë ekspozimin e tyre të kufizuar ndaj shërbimeve moderne financiare.
55. **Përpjekjet për mbrotjen e konsumatorit do të zvogëlojnë pabarazitë e informacionit, burimeve dhe pushtetit, të cilat janë karakteristikë për një marrëdhënie shërbimi midis individëve (ose bizneseve të vogla) dhe bankave ose ofruesve tjerë të shërbimeve të pagesave, jo banka.** Së bashku me ofrimin e informacionit për një vendimmarrje më të mirë të cekur më lartë, këto përpjekje do të përfshijnë ndalimin e bankave dhe ofruesve tjerë të shërbimeve të pagesave për tu angazhuar në praktika jo të drejta ose keqinformuese, duke u siguruar me legjislacion që të jenë vendosur drejtë mekanizmat e duhur të mbrojtjes së konsumatorëve dhe zgjedhjes së kontesteve me konsumatorët.

Parimi udhëzues 2: Infrastruktura e pagesave dhe rrjetet e qasjes moderne dhe ndërvepruese

56. **Infrastruktura moderne e pagesave do të shërbej për të mbështetur procesimin e pagesave përmes të gjitha llojeve të instrumenteve të pagesave.** BQK ka zbatuar dy nga infrastrukurat kryesore të pagesave që lejojnë kliringun e transfereve të kreditit me vlerë të vogël dhe shlyerjen e tyre finale përmes llogarive të shlyerjes. BQK do të mbështesë zhvillimin e infrastrukturave tjera të nevojshme (p.sh.: për procesimin e pagesave me kartela dhe mundësimin e pagesave të shpejta “Instant Payments”), edhe pse zbatimi dhe operimi efektiv i tyre do të jetë përgjegjësi e sektorit privat.
57. **Të gjitha infrastrukurat e pagesave që konsiderohen me rëndësi sistemike nga BQK do të zbatojnë “Parimet për infrastrukturën e tregut financiar” (PFMI) të nxjerra nga CPMI-IOSCO.** Infrastrukurat tjera të pagesave do të ndjekin praktikën më të mira ndërkombëtare dhe mund të kërkohet që të zbatojnë edhe nën-kategori të PFMI-ve të nxjerra nga CPMI-IOSCO. BQK në baza periodike do të vlerësoj shkallën e rëndësisë sistemike të infrastrukturave dhe do të përcaktoj standardet ndërkombëtare/praktikat më të mira që duhet të adaptohen nga infrastrukurat e pagesave (shih gjithashtu Parimin udhëzues 6).
58. **Qëlimi lidhur me infrastrukurat e pagesave dhe rrjetet e qasjes është që ato të jenë ndërvepruese, përmes zhvillimit të infrastrukturës së përbashkëtt për procesimin e pagesave me vlerë të vogël.** Kjo do të sigurojë një qasje të drejtë dhe të barabartë, si dhe do të mbështesë efikasitetin përmes minimizimit të rreziqeve financiare, operacionale etj. Rrjetet ndërvepruese të qasjes do të mundësojnë përdorimin e pandërprerë të produkteve të pagesave në lokacione të ndryshme në të gjithë vendin, me një kosto të arsyeshme.

Parimi udhëzues 3: Korniza e përshtatshme ligjore dhe rregullative

59. **Rregullat jo-diskriminuuese të hyrjes dhe kushteve të pjesëmarrjes në tregun për ofrimin e shërbimeve të pagesave me vlerë të vogël, do të ruhen dhe avancohen sipas nevojës.** Këto rregulla luajnë një rol kritik në sigurimin e konkurrencës dhe lehtësimin e pjesëmarrjes së gjerë në tregun e pagesave me vlerë të vogël, në nxitjen e inovacionit dhe në përgjithësi në vendosjen dhe ruajtjen e barazisë midis ofruesve të autorizuar të shërbimeve të pagesave, pavarësisht natyrës apo madhësisë së tyre.
60. **Rregullativa e pagesave do të ndjek zhvillimet e tregut dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.** Në aspektin rregullativ, veprimet e BQK-së do të synojnë funksionimin e mire të pagesave me vlerë të vogël dhe sistemit kombëtar të pagesave SKP-së në përgjithësi, duke ruajtur sigurinë e tyre dhe duke promovuar efikasitetin dhe përballueshmërinë e kostos së tyre, si dhe duke u siguruar që të zhvillohet në vazhdimësi për tu përshtatur me nevojat e ekonomisë së Kosovës në rritje, për shërbimet e pagesave.

Parimi udhëzues 4: Konkurrenca e fortë, e plotësuar me një bashkëpunim të fuqishëm

61. **Tregu për ofrimin e shërbimeve të pagesave me vlerë të vogël do të mbrohet nga sjellja anti-konkurrenuese e ofruesve individual të shërbimeve të pagesave apo e operatorëve të sistemeve të pagesave.** Akterët e tregut, nëse arrijnë të shfrytëzojnë pozicione monopoliste, mund të vënë në rrezik kapacitetet për inovacion, për rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe për ofrimin e shërbimeve të pagesave me çmime konkurrenuese për konsumatorët. Si mbikëqyrës i SKP, BQK është në pozitë të privilegjuar për të monitoruar zhvillimet e tregut dhe për të bashkëpunuar me autoritetin kompetent, në rast se identifikohen praktika monopoliste.
62. **Mbrojtja ndaj sjelljes anti-konkurrenuese nuk do të përjashtojë mundësinë që subjekte individuale të bëhen ofruese kryesore të shërbimeve kritike infrastrukturore, duke transferuar te klientët përfitimet e ekonomisë së shkallës dhe ndërveprimet përmes fushëveprimit të zgjeruar.** Megjithatë, mbrojtja e konkurrencës dhe kontestueshmërisë dhe aplikimi i rrept i rregullave kundër praktikave abuzive të tregut do të bëjnë të mundur që asnjë operator individual apo grup operatorësh të sistemit të pagesave të mund të keqpërdorin ofruesit e shërbimeve të pagesave ose të pengojnë hyrjet e reja në treg (shih më poshtë).
63. **Do të ndjeket vendosja e një ekuilibri midis konkurrencës dhe bashkëpunimit brenda industrisë së pagesave me vlerë të vogël.** Përderisa konkurrenca mundëson ofrimin e shërbimeve të pagesave me vlerë të vogël më inovative dhe me kosto efektive, bashkëpunimi ndërmjet akterëve të tregut dhe me BQK-në, është i domosdoshëm për ndërtimin e infrastrukturave të përbashkëta, për përcaktimin dhe adaptimin e standardeve të njëjta për shërbimet e pagesave dhe për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme kolektive. Prandaj, BQK do vazhdojë të nxisë nivelin e kërkuar të bashkëpunimit të industrisë përmes stimujve, rregullave, dialogut dhe bindjes morale. Për më tepër, BQK do të marrë rolin udhëheqës në nxitjen e nismave të sektorit privat, kurdo që është e nevojshme, me qëllim që të ndihmojë sektorin privat që të bëhet një forcë vetëfunksionuese për zhvillimin e një SKPVV-je të sigurt dhe efikase.

Parimi udhëzues 5: Qeverisja dhe përgjegjësitë e rrezikut

64. **Një kornizë e përshtatshme për menaxhimin e rrezikut do të sigurojë identifikimin dhe administrimin e duhur të rreziqeve dhe kostove në tregun e pagesave me vlerë të vogël.** Akterët e tregut duhet të jenë të vetëdijshëm për rreziqet dhe kostot gjatë projektimit dhe operimit të sistemeve të tyre. Është i nevojshëm ekuilibri ndërmjet reduktimit të rrezikut dhe kostove shoqëruese, i cili duhet të mirëmbahet duke pasur parasysh se zhvillimet e reja të tregut mund të ndryshojnë herë pasë here ekuilibrin ekzistues. Përderisa BQK vazhdon të mbikëqyrë SKP-në si një tërësi, si dhe të mbikëqyrë ofruesit e shërbimeve të pagesave / operatorët e sistemeve të pagesave, këta të fundit mbajnë përgjegjësinë kryesore për administrimin e rreziqeve që ata paraqesin për tregun e pagesave me vlerë të vogël dhe për SKP-në në tërësi.
65. **Do të ndiqet një qasje progresive, por e kujdesshme, ndaj zhvillimeve të reja teknologjike.** Është e domosdoshme që rreziqet e përfshira gjatë hapjes së SKP-së për akterët të rinj dhe instrumente të reja, të vlerësohen dhe të kuptohen në tërësi. Qasja e përgjithshme e BQK-së do të synojë pranimin dhe lehtësimin e inovacionit, duke u siguruar që rreziqet e identifikuar ose të mundshme të kuptohen, të vlerësohen dhe të menaxhohen drejtë, si dhe përgjegjësitë përkatëse të ndahen siç duhet.
66. **Marrëveshjet e arsyeshme dhe efektive të qeverisjes do të mbështesin ofrimin dhe ndarjen e shërbimeve infrastrukturore ndërmjet subjekteve të sektorit publik dhe privat.** Në mënyrë që të sigurohemi se infrastruktura e shërbimeve funksionon mirë dhe ofron ndërveprim, qeverisja e tyre duhet të reflektoj mbi nevojat dhe interesat e të gjitha institucioneve pjesëmarrëse, rregulltorëve dhe të ekonomisë si tërësi, duke ruajtur njëkohësisht ekuilibrin ndërmjet interesave private dhe qëllimeve publike.
67. **Operatorët e sistemeve të pagesave dhe ofruesit e shërbimeve të pagesave duhet që, në asnjë moment, të mos kryejnë veprime të cilat mund të rrezikojnë besimin e publikut në SKP ose më gjerë në sistemin financiar.** Besimi i publikut në sistemet e pagesave, veçanërisht në ato me vlerë të vogël, është shumë i rëndësishëm. Në këtë drejtim, BQK do të bashkëpunoj me autoritetet përkatëse, sipas nevojës, për tu mbrojtur nga të gjitha format e abuzimeve kriminale të sistemit të pagesave, siç janë mashtrimet, shkelja e integritetit të të dhënave, pastrimi i parave ose financimi i aktiviteteve të terrorizmit.

Parimi udhëzues 6: Mbikëqyrja efektive

68. **Nëpërmjet mbikëqyrjes, BQK synon ruajtjen e sigurisë së tregut të pagesave me vlerë të vogël dhe të SKP-së si tërësi, duke promovuar njëkohësisht efikasitetin, përballueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen.** BQK do të vazhdoj të përforcojë kapacitetet e saj të brendshme të nevojshme për të mbikëqyrur në mënyrë efektive një treg të pagesave gjithnjë më kompleks dhe në rritje. BQK do të rishikoj kornizën e saj të politikës së mbikëqyrjes në mënyrë që ta sjellë dhe ta mbajë atë në pajtueshmëri me parimet ndërkombëtare për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave.
69. **Në zbatim të përgjegjësisë të saj mbikëqyrëse, BQK do të vazhdojë me zbatimin e praktikave më të mira, në përputhje me parimet dhe standardet e zhvilluara nga komuniteti financiar ndërkombëtar.** Për mbikëqyrjen e instrumenteve, shërbimeve dhe skemave specifike të pagesave me vlerë të vogël, BQK do të adaptojë udhëzimet ndërkombëtare²⁴ dhe do të marrë në konsideratë përvojat dhe praktikat e zhvilluara nga

²⁴ Siç janë, parimet e nxjerra nga CPMI-Grupi i Bankës Botërore "Parimet e përgjithshme për shërbimet ndërkombëtare të remitencave" (2007) dhe parimet udhëzuese në kuadër të "Aspektet e pagesave për përfshirjen financiare" (raporti i v.2016).

bankat qendrore me synim adresimin e rreziqeve të shërbimeve dhe instrumenteve të pagesave me vlerë të vogël.²⁵ Për çdo sistem të pagesave me vlerë të vogël i cili përcaktohet nga BQK si sistem i rëndësisë sistemike, do të aplikohen parimet e adaptuara nga BQK përmes metodologjisë për vlerësimin e sistemeve të rëndësisë sistemike, të bazuara në parimet e nxjarra nga CPMI-IOSCO.

70. **Si pjesë e aktivitetit të saj mbikëqyrës, BQK do të sigurojë dialog të vazhdueshëm rreth politikave rregullative me të gjithë akterët relevant të tregut të pagesave me vlerë të vogël.** Një dialog i tillë do të jetë i nevojshëm për të siguruar përfaqësim të drejtë të gjithë interesave publike dhe private në proceset vendimmarrëse në lidhje me tregun e pagesave me vlerë të vogël. Kjo do të ndihmojë për të siguruar konsensus për zgjedhjen e politikave adekuate dhe për përmirësimin e cilësisë së procesit të përgatitjes së politikave, si dhe një kanal përmes të cilit do të mund të ofrojë udhëzime rreth orientimit të saj, për palët e interesuara dhe për të mësuar qëndrimet e tyre. Aty ku është e nevojshme, BQK do të përdorë dialogun si mënyrë për të shpërndarë njohuritë dhe për të bindur pjesëmarrësit e ndryshëm të tregut, mbi praktikën më të mirë për të gjithë industrinë, si dhe si mjet për të nxitur marrëveshje vullnetare për veprime kolektive në nivel industri (për shembull, për vendimet që përfshijnë investime në infrastrukturë dhe për masat për zvogëlimin dhe administrimin e rreziqeve).
71. **Si katalizator i ndryshimeve, BQK do të adaptojë dhe / ose promovojë masa për të mundësuar një evoluim dhe zhvillim më të shpejtë të tregut të pagesave me vlerë të vogël.** Për shembull, BQK do të lehtësojë adaptimin e standardeve të përbashkëta për lloje të caktuara të instrumenteve të pagesave, nga ana e ofruesve të shërbimeve të pagesave. Gjithashtu, do të sigurojë, nëse është e nevojshme edhe me anë të rregullativës, që operatorët e sistemeve të pagesave me vlerë të vogël dhe rrjeteve të pikave të qasjes të zhvillojnë rregullat dhe procedurat për shlyerjen efikase, të besueshme dhe të sigurtë të transaksioneve të pagesave me vlerë të vogël.

II.2. Fushat dhe veprimet strategjike

72. Veprimet e parashikuara për zbatimin e SKPVV-së, janë në përputhje me parimet udhëzuese të parashtruara më sipër dhe mund të kategorizohen në tetë fusha të gjera strategjike: (i) Përkushtimi i pjesëmarrësve/akterëve relevant ndaj zbatimit të SKPVV-së; (ii) Korniza ligjore dhe rregullative; (iii) Përmirësimi i infrastrukturës për pagesat dhe për mbështetjen e tyre; (iv) Shërbime të pagesave të përbalueshme dhe me fokus klientin, të bazuara në llogaritë e transaksioneve; (v) Rrjete të pikave të qasjes; (vi) Edukimi financiar; (vii) Shfrytëzimi i programeve me vëllim të lartë të pagesave për të arritur ekonominë e shkallës; dhe (viii) Mbikëqyrje efektive.

²⁵ Për shembull, ka disa raporte të Bankës Qendrore të Evropës, si: Qasja e harmonizuar e mbikëqyrjes dhe standardet e mbikëqyrjes së instrumenteve të pagesave (2009); Rekomandimet për sigurinë e pagesave përmes internetit (2013); Udhëzimi për vlerësimin e sigurisë së pagesave përmes internetit (2014); Udhëzimi për vlerësimin e skemave të transfereve të kreditit ndaj standardeve të mbikëqyrjes (2014); dhe, Udhëzimi për vlerësimin e skemave të pagesave me kartelë ndaj standardeve të mbikëqyrjes (2015), si dhe Korniza e rishikuar e mbikëqyrjes së pagesave me vlerë të vogël (2016).

i) Përkushtim më i madh i palëve të interesuara

Lehtësimi i reformës së tregut të pagesave me vlerë të vogël si një përpjekje e përbashkët e sektorit publik dhe atij privat

73. **Këshilli Kombëtar i Pagesave (KKP) në Kosovë do të zgjerojë anëtarësinë e tij dhe do të rifreskojë aktivitetet e tij për lehtësimin e zbatimit të SKPVV-së, si dhe të ngrisë nivelin e cilësisë së dialogut gjithëpërfshirës në politikëbërje.** KKP ka shërbyer si një forum i rëndësishëm për të lehtësuar diskutimet ndërsektoriale mbi çështjet e sistemit të pagesave. Për lehtësimin e reformimit të tregut të pagesave me vlerë të vogël dhe për sigurimin e vazhdimësisë së dialogut mes pjesëmarrësve, KKP do të zgjerojë përbërjen e tij duke përfshirë edhe ofruesit e shërbimit të pagesave jo-banka si anëtarë me të drejtë vote. Për më tepër, KKP do të luaj një rol më aktiv dhe më të dukshëm në kontekstin e SKPVV-së. Prandaj, KKP do të:
- Krijojë një grup punues për monitorimin dhe raportimin e progresit të zbatimit të SKPVV-së, si dhe për të njoftuar mbi pengesat që hasen dhe për të sugjeruar përfshirjen e KKP-së sipas nevojës.
 - Krijojë një grup të koordinimit i cili do të sigurojë që të ketë një koordinim efektiv lidhur me burimet e nevojshme për avancimin e përfshirjes financiare dhe arritjes së objektivave kryesore të SKPVV-së.
74. **BQK dhe KKP si një organ konsultativ, do të nxisin përfshirjen më të madhe të mundshme të sektorit privat në vendimet që janë në interes të përbashkët dhe kanë rëndësi publike për tregun kombëtar të pagesave me vlerë të vogël.** Këto fusha mund të përfshijnë aspekte të tilla si zgjedhjet lidhur me standardet operacionale, projektimin dhe adaptimin e infrastrukturës, mënyrat për të arritur ndërveprim në mes të instrumenteve të pagesave psh ndërmjet llogarive bankare dhe llogarive të parasë elektronike, menaxhimin e rrezikut, si dhe adresimin e çështjeve të cilat lidhen me besimin e publikut.
75. **BQK synon të shfrytëzojë burimet e ndryshme nga asistencat teknike të ekspertëve të jashtëm, agjencioneve të specializuara apo institucioneve simotra nga vendet tjera, lidhur me adresimin e sfidave të SKPVV.** Organizatat Ndërkombëtare janë një burim shumë i rëndësishëm i asistencave të mundshme teknike, përderisa dialogu dhe shkëmbimet me banka qendrore dhe autoritete relevante të vendeve tjera mund të ofrojnë mundësi të rëndësishme të veçantë në shkëmbimin dhe mësimin nga përvojat e aplikuara.

Avancimi i qasjes në llogaritë e transaksioneve

76. **Kosova do të adaptojë një qasje të kujdesshme, të koordinuar dhe strategjike, që përfshinë dhe angazhon, si sektorin publik edhe atë privat, në zgjerimin e qasjes në llogaritë e transaksioneve dhe rritjen e përfshirjes financiare.** Grupi Punues me anëtarët dhe/ose përfaqësuesit nga KKP, do të krijohet për të siguruar që burimet dhe veprimet e gjithë pjesëmarrësve të koordinohen për të arritur një përfshirje më të gjerë financiare.²⁶ Në fazën e parë (2021-2023), Grupi i koordinimit do të fokusohet në avancimin e qasjes dhe përdorimit të llogarive të transaksioneve. Në fazën e dytë, do të përfshihen edhe shërbimet tjera financiare të cilat duhet të jenë gjerësisht të disponueshme për individët dhe bizneset në Kosovë, si kreditë, kursimet dhe produktet e sigurimeve.

²⁶ Duke përfshirë gjithashtu se qëllimet specifike dhe strategjike lidhur me përfshirjen financiare të jenë konsistente me SKPVV.

Ndërtimi i kapaciteteve në gjithë industrinë e pagesave

77. **BQK në bashkëpunim me akterët tjerë, do të kërkojë zhvillimin e kapaciteteve dhe njohurive të mjaftueshme për çështjet e pagesave me vlerë të vogël.** Pjesëmarrja aktive e bankave dhe pjesëmarrësve tjerë të industrisë financiare, si dhe bashkëpunimi dhe investimi me/nga sektori privat janë të domosdoshme. Përpjekjet e përbashkëta do të synojnë të adresojnë nevojat e burimeve njerëzore të industrisë, nëpërmjet seminareve, punëtorive dhe asistencave teknike. Për këtë qëllim, nismat për ndërtimin e kapaciteteve dhe sesionet e trajnimeve do të organizohen, nëse është e nevojshme, edhe me mbështetjen e jashtme nga organizatat ndërkombëtare dhe institucionet e jashtme partnere.

ii) Konsolidimi i një mjedisi rregullator të favorshëm për pagesat me vlerë të vogël

Sigurimi i neutralitetit dhe proporcionalitetit të rregullativës

78. **BQK do të adoptojë direktivat relevante të BE-së, psh. PSD 2, EMD, Direktiva për Shlyerjen Finale, të cilat do të ndihmojnë në sigurimin e një qasje më konsistente në rregullimin e llojeve të ndryshëm të ofruesve të shërbimeve të pagesave.** Përmes kësaj mënyre, BQK do të mbështes një neutralitet ndaj modelit të biznesit apo teknologjisë. Kjo do të mundësojë zhvillimin e shërbimeve të reja të pagesave, duke siguruar njëkohësisht kushte të barabarta të operimit për ofruesit ekzistues dhe ofruesit e rinj të shërbimeve të pagesave.
79. **Në këtë mënyrë do të sigurohet një qasje funksionale e rregullimit të pagesave.** Kjo përfshinë përcaktimin e kërkesave rregullative në mënyrë konsistente ndaj ofruesve të ndryshëm të shërbimeve të pagesave, duke lehtësuar më tej hyrjen në treg, si dhe një ambient me mundësi të barabarta për konkurrencë dhe inovacion dhe për adresimin e rreziqeve. Një kornizë e tillë do të jetë proporcionale ndaj rreziqeve të cilat IFJB-të e autorizuara për ofrimin e shërbimeve të pagesave, emetimin e aprave elektronike, produktet e reja dhe modelet e reja të biznesit, mund të paraqesin për sistemin.
80. **BQK, në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët relevant të KKP-së, do të rishikoj në vazhdimësi kornizën ligjore dhe rregulative të tregut të pagesave me vlerë të vogël në Kosovë.** Ky rishikim është i rëndësishëm për sa i përket ritmit të shpejtë të avancimit teknologjik, ndryshimit të shpejtë të praktikave biznesore dhe evolucionit të shpejtë të tipologjive të rrezikut (duke përfshirë lloje të ndryshme të krimeve siç janë krimet dhe mashtrimet kibernetike), të cilat karakterizojnë tregjet moderne të pagesave me vlerë të vogël. Një rishikim i përbashkët gjithëpërfshirës do të kryhet të paktën një herë në vit, ose më shpesh nëse do të jetë e nevojshme, me propozimet për amandamentimet e nevojshme rregullative.

Mundësimi i modeleve inovative të biznesit dhe teknologjisë

81. **Përdorimi i palëve të treta si agjentë apo nën agjentë për ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe shërbimeve tjera të lidhura me pagesat, rregullohen tërësisht nga BQK.** Rregullorja e re lidhur me agjentët është miratuar dhe ka hyrë në fuqi në janar 2020. BQK ka qartësuar kërkesat minimale të cilat agjentët duhet ti plotësojnë, si dhe në mënyrë të qartë ka përcaktuar se bankat dhe/apo IFJB-të si kontraktues të agjentëve, bartin përgjegjësitë e plota lidhur me veprimet e agjentëve të tyre. Gjithashtu, dispozitat e marrëveshjeve me agjentët me anë të cilave ju vendoset ekskluziviteti, janë të ndaluara në mënyrë eksplicite.
82. **BQK është duke zhvilluar kornizën rregullative përmes së cilës do të rregulloj në mënyrë konsistente kontraktimin e shërbimeve nga palët e treta në sektorin e pagesave, me një fokus të veçantë në përdorimin e shërbimeve nga ofrues të**

shërbimeve teknike. Rregullorja e re siguron që nënkontraktimi i funksioneve operacionale të rëndësishme nuk ka ndikim material në cilësinë e kontrollave të brendshme të ofruesit të shërbimeve të pagesave apo operatorit të sistemit të pagesave dhe mundësinë e BQK-së që ta ushtroj mbikëqyrjen e saj efektive ndaj atij institucioni. BQK, gjithashtu rezervon të drejtën e shtrirjes së mbikëqyrjes së saj dhe vendosjes së kërkesave të saj edhe për ofruesit e shërbimeve teknike për subjektet e mbikëqyrura.

83. **BQK, në rolin e saj të katalizatorit, do të inkurajoj dhe promovoj përdorimin e shërbimeve dhe instrumenteve inovative të pagesave.** Në këtë kontekst, do të studioj mundësitë e adaptimit të pagesave të shpejta “Instant Payments” të cilat mund të përdoren për një mori të rasteve, përfshirë këtu edhe pagesat e ndryshme të individëve ndaj bizneseve përmes pikave të shitjes siç janë kodet e njohura si “QR code”. Pagesat e shpejta mund të kontribuojnë në zvogëlimin e kostos së inicimit dhe pranimit (marrë parasysh se ato kryesisht ndërliken me kredit transferet si instrumente bazike të pagesave), shlyerjen e menjëhershme për përdoruesit, si dhe disponueshmërinë përgjatë 24/7/365. Si tërësi, tregu i pagesave në Kosovë do të mund të përfitonte nga format e reja të pagesave dhe solucionet e reja që mund të ofrojnë kompanitë e njohura si FinTech të bazuara kryesisht në zgjidhje teknologjike, marrë në konsideratë se deri tani bankat komerciale kanë qenë ofruesit kryesor të shërbimeve të tilla. Përderisa, bankat nuk janë treguar proaktiv mjaftueshëm dhe nuk kanë ofruar zgjidhje inovative ndërvepruese nga të cilat do të mund të përfitonin përdoruesit dhe të cilat do të mund të zgjeronin përfshirjen financiare dhe të përmbushnin nevojat e segmenteve të ndryshme të popullatës dhe tregtarëve. Ndryshimet e reja rregullative pritet që gjithashtu të ndikojnë në rritjen e tregut të pagesave jo-cash në vend.

Mbrojtja e të drejtave të përdoruesve, transparenca dhe promovimi i të mirës për publikun

84. **Qeveria e Kosovës, nëpërmjet Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, i ka ofruar BQK-së kompetencat dhe përgjegjësitë për monitorimin dhe zbatimin e mbrojtjes së përdoruesve për shërbimet e pagesave dhe shërbimet tjera financiare.** Agjencia relevante për mbrojtjen e konsumatorit nën Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me BQK-në për të shtrirë autoritetin e saj për mbrojtjen e konsumatorëve të shërbimeve financiare të BQK-ja. Në fushën e pagesave, BQK do të sigurojë konsistencë përmes dispozitave mbi transparencën dhe mbrojtjen e konsumatorit të cilat rrjedhin me përafrimin e legjislacionit me direktivën e BE-së për shërbimet e pagesave të njohur si PSD2.
85. **BQK do të vazhdoj punën e saj për sigurimin se të drejtat e përdoruesve të shërbimeve të pagesave janë të mbrojtura.** Në këtë mënyrë, përdoruesit duhet të kenë një mekanizëm lehtësisht të qasshëm dhe të përballueshëm për zgjidhjen e kontesteve me ofruesit e shërbimeve të pagesave jashtë proceseve gjyqësore. Ndër tiparet tjera, BQK do të përfshij edhe procedura të qarta, të qasshme nga publiku dhe lehtësisht të aplikueshme në rastet e mashtrimeve dhe konflikteve, të cilat do të jenë në dispozicion të konsumatorëve, pavarësisht nga lloji i institucionit që ofron shërbimin e pagesave. Zbatimi i këtyre rregullave do të monitorohet në vazhdimësi nga Divizioni i BQK-së për adresimin e ankesave të konsumatorëve, në bashkëpunim me departamentet e mbikëqyrjes së institucioneve që ofrojnë shërbimet e pagesave dhe të mbikëqyrjes së instrumenteve të pagesave.

Parandalimi i përdorimit të tregut të pagesave me vlerë të vogël (dhe i SKP-së më gjerësisht) për qëllime kriminale

86. **BQK dhe Njësia e Intelgjencës Financiare në Kosovë, do të eksplorojnë më tutje mundësitë e aplikimit të masave të thjeshtësuara në rastin e përdorimit të instrumenteve të parasë elektronike.**²⁷ Në rrethana të caktuara, të dëshmuara me rrezik më të ulët dhe nën kushte strikte të administrimit të rrezikut, është e mundshme të thjeshtësohen masat e aplikuara të njohjes dhe validimit të klientit të produkteve të parave elektronike, lidhur me identifikimin dhe verifikimin e vet klientit dhe pronarit përfitues (përfshirë këtu biznest mikro dhe të vogla), duke vazhduar njëkohësisht aplikimin dhe monitorimin e limiteve të transaksioneve të tyre.

Shfrytëzimi i shërbimeve të identifikimit elektronik

87. **Ministria e Zhvillimit Ekonomik, si ministri përgjegjëse për sektorin e TIK në Republikën e Kosovës, si dhe agjencitë tjera relevante të qeverisë, do të sigurojnë që Draft Ligji i ri për “Identifikimin elektronik dhe shërbimet e besimit për transaksionet elektronike”²⁸ do të finalizohet dhe të procedohet për miratim sa më shpejtë që të jetë e mundur.** Ligji i ri, i cili do të zëvendësoj ligjin përkatës ekzistues²⁹, pritet të vendos kornizën e nevojshme ligjore për identifikimin e sigurt elektronik, vulosjen elektronike, shërbimet elektronike mediale dhe autentifikimin e uebfaqeve në Republikën e Kosovës. Benefitet kryesore që priten me zbatimin e tij janë avancimi i sigurisë për transaksionet elektronike, sigurimi i një baze të përbashkët për interakcionin e sigurt elektronik ndërmjetë qytetarëve, bizneseve dhe autoriteteve publike, përmirësimi i efektivitetit të ofrimit të shërbimeve publike dhe private nga distanca dhe shërbimeve të tregtimit online (e-Commerce) në Republikën e Kosovës.

iii) Përmirësimet e infrastrukturës së pagesave dhe shërbimeve tjera mbështetëse

Duhet të jenë të gatshme të gjitha infrastrukturat dhe instrumentet kryesore të pagesave

88. **BQK dhe pjesëmarrësit e ACH, në bashkëpunim me faturuesit e mëdhenjë të shërbimeve publike në Kosovë, do të rrisin përdorimin e infrastrukturës së debitimit direkt, e cila veç është operacionale aktualisht në ACH, edhe përmes avancimit të kornizës ligjore.** Secili faturues do të mund ta debitoj cilëndo bank pjesëmarrëse në sistemin e pagesave, përmes aktivizimit të një llogarie të caktuar, e cila mund të rezultoj me përfitime në kosto dhe rritje të efikasitetit. Për më tepër, debitimi direkt ndërbankar do t'i barazoj më tutje kushtet e tregut, sidomos për bankat e vogla, të cilat do të mund të tërheqin më tepër faturues të mëdhenjë, si dhe llogari mbajtës të cilët kanë nevojë ti paguajnë shërbimet që marrin nga këta faturues.
89. **BQK do të analizojnë mundësitë e adaptimit të infrastrukturës së nevojshme për procesimin e pagesave të shpejta të njohura si “instant payment” dhe do të nxisë sektorin privat për zhvillimin e saj.** Një platëformë e tillë do të mundësoj iniciimin dhe shlyerjen e pagesave me vlerë të vogël në kohë reale, duke rritur kështu shpejtësinë e kryerjes dhe ekzekutimit të pagesave përgjatë një orari 24/7/365. Një shërbim i tillë konsiderohet si

²⁷ Direktiva e Bashkimit Evropian 2018/843 në amandamentim të Direktivës 2015/849 “Mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” dhe të Direktivave 2009/138/EC dhe 2013/36/BE.

²⁸ Transpozimi i Rregullores së BE 910/2014 “Mbi identifikimin elektronik dhe shërbimet e besimit për transaksionet elektronike në kuadër të tregut të brendshëm, dhe shfuqizimi i Direktivës 1999/93/EC”.

²⁹ Ligji Nr. 04/L-094 “Mbi shërbimet e shoqërive informative”.

shërbim shtesë që mundëson përfshirjen e rasteve tjera të pagesave, i cili do të krijonte më shumë mundësi për ofruesit ekzistues dhe të rinjë të shërbimeve të pagesave, si dhe për tregtarët, p.sh. pagesat përmes skanimit të kodeve të njohura si “QR code” me aplikacione të mobilit, si zëvendësim i terminaleve me kosto më të lartë që përdoren aktualisht. Interoperabiliteti/ndërveprimi prej një llogarie në llogarinë tjetër mund të arrihet nëpërmjet aplikacioneve për ndërlidhje të programuara (Application of Programming Interface – API), marr parasysh se në një sistem të tillë do të marrin pjesë ofrues të ndryshëm të shërbimeve të pagesave, të cilët ju shërbejnë klientëve të tyre llogari të ndryshme të transaksioneve.

Duhet të ofrohet qasje e drejtë dhe e paanëshme në infrastrukturën e pagesave

90. **BQK do të sigurojë që rregulloret dhe rregullat e tjera të të gjitha infrastrukturave të sistemeve të pagesave në vend, të garantojnë qasje të drejtë dhe të hapur, duke ndërmarr njëkohësisht të gjitha masat mbrojtëse të nevojshme ndaj rreziqeve financiare, operacionale dhe të tjera. Aty ku vlerësohet e nevojshme, do të bëhen edhe ndryshime ligjore.** Lidhur me Sistemin Ndërbankar të Pagesave dhe infrastrukturat tjera të ardhshme, BQK do ti përmbahet Parimit 18 të CPMI-IOSCO për infrastrukturën e tregjeve financiare (“Infrastruktura e tregut financiar duhet të ketë kritere objektive, të bazuara në rrezik dhe të shpalosura publikisht për pjesëmarrjen në sistem, të cilat lejojnë qasje të drejtë, të paanëshme dhe të hapur”), si dhe do të ndjek praktikën më të mira ndërkombëtare. BQK do të përfitojë nga angazhimi i saj aktual në transpozimin e Direktivës së BE-së PSD2, për të adaptuar ndryshimet e nevojshme ligjore në lidhje me këtë qëllim, për sa i përket sistemeve të pagesave me vlerë të vogël.
91. **Në mënyrë të veçantë, BQK do të shqyrtojë mundësitë e pjesëmarrjes së IFJB-ve si pjesëmarrës direkt në sistemin ndërbankar të pagesave, por edhe të çfarëdo platëforme të ardhshme për mundësimin e pagesave të shpejta.** Kjo mund të jetë e dobishme për disa nga IFJB-të të cilat ofrojnë shërbimet e pagesave dhe/ose emetimin e parave elektronike. BQK do të zhvilloj dhe përfshijë në kuadër të rregullores për sistemin ndërbankar të pagesave, kriteret objektive, transparente dhe të bazuara në rrezik, të cilat duhet të përmbushen për qasjen e tyre në ACH dhe RTGS. Gjithashtu, kritere të ngjashme, me plotësimet sipas nevojës, do të aplikohen edhe për pjesëmarrjen në infrastrukturat e ardhshme që implementohen për mundësimin e pagesave të shpejta.

Minimizimi i rreziqeve financiare dhe rreziqeve tjera

92. **Manaxhimi i rrezikut kreditor dhe të likuiditetit në ACH do të fuqizohet nga BQK në rolin e saj si operator dhe mbikëqyrës i sistemit të pagesave.** Pozicionet net të pjesëmarrësve do të kolateralizohen në avans. Së bashku me zvogëlimin e rrezikut kreditor dhe rrezikut të likuiditetit, kjo masë do të lehtësoj IFJB-të që të bëhen pjesëmarrës të drejtëpërdrejtë në ACH (pasi që në këtë formë nuk do të kishin nevojë për qasje në instrumentet e huave brenda ditore të BQK-së si instrumente sigurie për shlyerjen e pozicioneve të tyre në ACH). BQK do të analizojë vendosjen e limiteve për sa i përket pozicionit të debitit neto të tyre dhe të pjesëmarrësve tjerë në ACH.
93. **SPN do të vlerësohet në mënyrë të detajuar kundrejt Parimeve të CPMI-IOSCO për infrastrukturën e tregut financiar.** BQK do të kryejë një vetëvlerësimin e dy komponentëve të SPN-së (RTGS dhe ACH) dhe do të sigurohet për vlerësimin e tyre periodik dhe në mënyrë të pavarur nga divizioni i mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave.

94. **BQK dhe ofruesit tjerë të shërbimeve të pagesave do të adresojnë me kujdesë të veçantë rrezikun nga sulmet kibernetike dhe do të ndërmarrin masat adekuate kurdo që është e nevojshme.**³⁰ Me evoluimin e shpejtë të teknologjisë së sistemeve dhe instrumenteve të pagesave, rritet edhe rreziku nga sulmet kibernetike. Për të zvogëluar këto rreziqe, BQK dhe ofruesit tjerë të shërbimeve të pagesave do të sigurojnë masa adekuate të sigurisë lidhur me pagesat elektronike, për të parandaluar abuzimet me të dhënat personale dhe fondet e klientëve, të cilat do të ndikonin negativisht në besimin e konsumatorëve për përdorimin e instrumenteve të pagesave. Për më tepër, do të sigurojnë masa adekuate për aktivitetin e sistemeve të pagesave për të mbrojtur integritetin e tyre dhe për të siguruar funksionimin e vazhdueshëm të tyre.

iv) Shërbime pagesash të përballeshme dhe me fokus klientin, të bazuara në llogari

Dizajnimi i produkteve të pagesave kryesore për individët që nuk posedojnë llogari bankare

95. **Sistemi financiar, nën drejtimin e BQK-së dhe me mbështetjen e SHBK-së, do të krijojë dhe do të ofrojë llogari “bazike” të transaksioneve**³¹ **për klientë që nuk posedojnë llogari bankare.** Aktualisht, kjo është duke u adresuar përmes përgatitjes së rregullores nga BQK për transpozimin e Direktivës së BE-së për llogaritë e pagesave.³² Si rezultat i kësaj, personat që aktualisht nuk posedojnë llogari dhe nuk janë të përfshirë në shërbimet bankare, do të mund të përfitojnë qasje në një gamë më të gjerë të shërbimeve financiare, si kreditë, kursimet dhe investimet. Përveç bankave, edhe IFJB-të do të mund të ofrojnë llogari për transaksione, të cilat janë bazë për një përfshirje më të gjerë financiare.
96. **Dizajnimi i llogarive të transaksioneve me veçori “bazike” do të sigurojë që të jenë ekonomikisht të përballeshme, duke ruajtur njëkohësisht tiparet thelbësore të një llogarie të transaksioneve.** Në minimum, llogaritë bazike të transaksioneve do të mundësojnë për kategoritë e synuara të popullatës, ruajtjen e mjeteve në mënyrë të sigurt, si dhe dërgimin dhe pranimin e pagesave në formë elektronike, me një kosto të ulët apo pa kosto. Në përcaktimin e strukturës së çmimeve dhe karakteristikave tjera të llogarive bazike të transaksioneve, bankat dhe IFJB-të do të kenë në konsideratë faktin që kategoritë e synuara të popullësisë për këto llogari do të jenë individë të varfër të cilët nuk mund të përballojnë mbajtjen e një gjendje të nevojshme minimale në llogari apo koston e mirëmbajtjes së llogarisë. Sidoqoftë, këto llogari bazike do të bëjnë të mundur që kategoria e individëve të synuar të mund të transferojnë (pranojnë) fonde dhe të paguajnë në mënyrë elektronike për/nga sa më shumë palë të jetë e mundur, por në veçanti për/nga ato palë me të cilat këta individë kryejnë transaksione të rregullta për shërbime rutinë.

Përdorimi i çmimeve si nxitje e rritjes së përdorimit të pagesave elektronike

97. **BQK do të zhvilloj një databazë të çmimeve të produkteve dhe shërbimeve financiare, për të mundësuar krahasimin ndërmjet institucioneve (bankave, IFJB-**

³⁰ Shiko gjithashtu: CPMI “Guidance on cyber resilience for financial market infrastructures”, Qershor 2016; Eurosystem cyber resilience strategy for FMI, Mars 2017; CPMI “Reducing the risk of wholesale payments fraud related to endpoint security: a toolkit”, October 2019; ECB “Cyber resilience for financial market infrastructures”, Nëntor 2019.

³¹ Shiko Nenin 17 të Direktivës së BE-së 2014/92/EU “On the comparability of fees related to payment accounts, payment account switching and access to payment accounts with basic features” mbi karakteristikat e llogarive të pagesave me tipare bazike dhe kutit 3 dhe 4 në Raportin “Payment Aspects of Financial Inclusion”.

³² Direktiva e BE-së 2014/92/EU “On the comparability of fees related to payment accounts, payment account switching and access to payment accounts with basic features”.

ve dhe IMF-ve) dhe do të publikojë këtë databazë në uebfaqen e saj. Përmbajtja e kësaj databaze të çmimeve do të rishikohet në baza të rregullta për të siguruar përfshirjen e të gjitha të dhënave dhe elementeve relevante që mundësojnë dhe janë të nevojshme për konsumatorët e bankave dhe IFJB-ve, për krahasim e produkteve/shërbimeve dhe marrjen e vendimeve të mirë informuara.

v) Zgjerimi i pikave të qasjes dhe rrjeteve për kryerjen e pagesave

Zhvillimi i modelit të bankingut përmes agjentëve

98. **Bankingu përmes agjentëve do të zhvillohet për të rritur afërsinë dhe përshtatshmërinë e hapjes së dhe operimit me llogari të transaksioneve, për të gjithë përdoruesit.** Përdorimi i llogarive të transaksioneve do të rritet duke arritur një mbulim më të madh të sistemit bankar dhe të pagesave, veçanërisht për ata individë që jetojnë/punojnë larg nga qytetet e mëdha. Përveç përgatitjes së ndryshimeve të nevojshme rregullative, BQK do të lehtësojë krijimin e modelit të bankingut përmes agjentëve, në koordinim me bankat dhe ofruesit tjerë të shërbimeve të pagesave, të cilët janë të interesuar të krijojnë marrëdhënie për ofrimin e shërbimeve përmes agjentëve, duke monitoruar njëkohësisht zhvillimin e këtij modeli nëpër gjithë Kosovën.
99. **BQK do të nxisë bashkëpunimin ndërmjet bankave dhe IFJB-ve.** Duke pasur parasysh përvojën në ofrimin e shërbimeve në zonat rurale dhe komunitetet tjera më të izoluar, është jashtëzakonisht e dobishme të ruhet shtrirja e degëve dhe të zgjerohet rrjeti i mundësive të hapjes dhe përdorimit të llogarive të pagesave jashtë qendrave kryesore urbane në Kosovë. Kjo mund të bëhet edhe përmes angazhimit të IFJB-ve si agjent bankar për shpërndarjen e pensioneve, skemave sociale dhe pagesave tjera, prandaj rekomandohet zgjerimi i një modeli të tillë bankë agjentë për shtrirjen e shërbimeve të pagesave në të gjithë vendin. Bankat dhe IFJB-të, do të jenë në gjendje të zgjedhin lirshëm ata agjentë që ato besojnë se janë më të përshtatshëm për planin dhe nevojat e tyre të biznesit.

Zhvillimi i ndërveprimit/interoperabilitetit

100. **Me rritjen e ndërveprimit ndërmjet kanaleve dhe instrumenteve të ndryshme të pagesave do të arritej një rritje efektive e pikave të qasjes.** Një rrjet i pikave të qasjes, ndërveprues, do të mundësonte një përdorim të unifikuar të produkteve të ndryshme të pagesave nëpërmjet lokacioneve të shumta nëpër gjithë vendin.

Nxitja e pranimit më të lartë të pagesave elektronike nëpërmjet çmimeve dhe stimujve

101. **Ministria e Financave Punës dhe Transfereve mund të analizojë mundësinë e ofrimit të stimujve të ndryshëm që do të nxisin pranimin e pagesave elektronike nga tregtarët.** Megjithatë, pasi të ndërmerren këto masa duhet të aplikohen si nxitës të përkohshëm të cilët do të kontribuonin në rritjen e përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike. Stimuj të tillë mund të përfshijnë, por pa u kufizuar, ofrimin e një subvencioni të përkohshëm për bizneset e vogla për marrjen me qira të terminaleve POS ose pajisjeve tjera të pranimit të transaksioneve, sigurimin e një përfitimi të përkohshëm fiskal për blerjet në të cilat biznesi ka pranuar kartelat ose instrumentet tjera elektronike si mjet pagese, etj.
102. **BQK do të ju kërkoj bankave të cilat janë edhe pranues të pagesave me kartela “Acquirer” të jenë transparente në tarifat që ato aplikojnë ndaj tregtarëve, duke përfshirë vënien e këtij informacioni në dispozicion të tyre në një formë të**

standardizuar. BQK gjithashtu do të mbledhë rregullisht të dhëna mbi këto tarifa. Kostoja e pranimit të pagesave përmes kartelave është një nga faktorët kryesor përcaktues për bizneset që ti pranojnë ato. Këto kosto përfshijnë tarifat mujore të qirasë për pajisjet e pranimit, normën e zbritjes së tregtarit për transaksion (Merchant Discount Rate) dhe tarifat tjera mujore ose për transaksion. BQK do të aplikojë kërkesat e transparencës mbi procesin e përfshirjes së tregtarit (për tregtarët që pranojnë ose janë të interesuar të pranojnë pagesat me kartela) të ngjashme me ato që tashmë janë të aplikuara për llogarimbajtësit. BQK do të inkorporoj të dhënat lidhur me shërbimet e përfshirjes së tregtarëve (si pjesë e të dhënave të mbledhura në kuadër të mbikëqyrjes nga pranuesit e shërbimeve të pagesave) në kuadër të databazës së çmimeve të shërbimeve financiare dhe do ta publikojë këtë informacion në kuadër të faqes së saj të internetit.

vi) Përpjekjet efektive për edukimin financiar

Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për SKPVV dhe përfitimet prej saj

- 103. BQK dhe SHBK do të hartojnë mesazhe bindëse për të shpjeguar se cilat janë përfitimet nga zbatimi i SKPVV-së për Kosovën.** Ato gjithashtu do të përgatisin njoftimet lidhur me masat për zvogëlimin e rrezikut, të drejtat dhe përgjegjësitë e përdoruesve dhe mekanizmat në dispozicion për adresimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve. Komuniteti i biznesit dhe publiku i gjerë duhet të njoftohen me objektivat strategjike, përmes informimit të publikut dhe fushatave edukative.

Informimi dhe edukimi i përdoruesve ekzistues dhe atyre potencial mbi llogaritë dhe pagesat elektronike

- 104. BQK, subjektet tjera të sektorit publik dhe ofruesit e shërbimeve të pagesave, do të intensifikojnë përpjekjet e tyre për të edukuar qytetarët e Kosovës dhe banorët e vendit mbi përdorimin e llogarive të pagesave dhe pagesave elektronike, përmes ofrimit të informacionit në rritje për grupe të targetuara.** Përpjekjet për edukim financiar do të drejtohen ndaj aspekteve kryesore që pengojnë individët dhe bizneset për të ndryshuar zakonet dhe sjelljet e tyre karshi pagesave. Prandaj, këto përpjekje do të adresojnë veçanërisht mënyrën se si llogaritë mund të ndihmojnë në mënyrë efektive në përmbushjen e nevojave të individit për pagesa apo ruajtje të fondeve, si dhe do të targetojnë faktor specifikë të “frikës” si: (i) perceptimi i mungesës së provës dëshmuese të kryerjes së pagesës në rastet kur mungon konfirmimi në letër; (ii) frika se format e reja të pagesave mund të jenë më të rrezikuara nga mashtrimet; (iii) frika nga përballja me sisteme të papërgjegjshme dhe të komplikuar, të prirura për gabime operacionale; dhe, (iv) perceptimi i humbjes së privatësisë.
- 105. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të ofrojnë trajnime praktike gjatë procesit të përvetësimit të konsumatorëve.** Kjo i referohet të kuptuarit e konsumatorit se si funksionon një produkt apo shërbim i pagesës në praktikë, përfshirë këtu edhe dobësitë dhe problemet që mund të hasen me përdorimin e tij. Rëndësi e veçantë do ti kushtohet përdoruesve të rinj me ekspozim të kufizuar ndaj shërbimeve elektronike të pagesave. Trajnime praktik do të ofrohet edhe për klientë ekzistues ose të rinjë, si pjesë e përdorimit të produkteve apo shërbimeve të reja ose plotësuese të pagesave.
- 106. Agjencia e Shoqërive Informative nën Ministrinë përkatëse, do të angazhohet në funksionalizimin e plotë të e-portalit me mundësinë e kryerjes së pagesave (e-qeverisje) për shërbimet e qeverisë.** Kjo Ministri do të fokusohet gjithashtu në edukimin e

publikut të gjerë mbi mënyrën e përdorimit efektiv dhe me një shtrirje sa më të gjerë që është e mundur (psh. duke përfshirë pagesat online aty ku është e mundur).

107. **Segmenteve të caktuara të popullsisë, siç janë pranuesit e remitencave, do të ju ofrohet një kujdes i veçantë, marrë parasysh shpeshtësinë e flukseve të pagesave që ata pranojnë.** Shumica e remitencave në Kosovë pranohej përmes formave fizike (letër / para të gatshme), prandaj ekziston potencial në edukimin e pranuesve lidhur me pagesat dhe kanalet elektronike me kushte më efektive dhe kosto më të ulët. Në këtë kontekst, BQK dhe autoritetet tjera relevante do të vazhdojnë me zbatimin e projektit “Greenback 2.0”, një iniciativë kjo e Bankës Botërore. Projekti Greenback 2.0 ka për qëllim rritjen e efikasitetit të tregut të remitencave përmes formave inovative të promovimit të ndryshimeve të inspiruara nga nevojat reale të përfituesve përfundimtar prej transferuesve ndërkombëtar të parave, siç janë pranuesit e remitencave. Qyteti i Prizrenit është zgjedhur si qytet kampion për zhvillimin e projektit Greenback. Përmes fushatave edukative dhe informuese dhe punëtorive të ndryshme, projekti fokusohet tek emigrantët dhe nevojat e tyre, njëkohësisht duke punuar me akterë tjerë relevant siç janë ofruesit e shërbimeve të remitencave, qeverisja komunale, universitetet dhe organizatat jo-qeveritare.
108. **BQK do të vlerësoj në mënyrë sa më objektive që është e mundur, efektivitetin e përpjekjeve dhe programeve të edukimit financiar të cilat janë ndërmarr deri tani.** Kjo është e domosdoshme për marrjen e vendimeve të drejta mbi ndryshimet dhe/ose përmirësimet e nevojshme në aspektet si materialet e trajnimit, formën se si ato janë shpërndarë/ofruar, grupet e targetuara, etj. Disa nga aspektet që duhet vlerësuar dhe matur mund të përfshijnë, sa persona janë të vetëdijesuar me pagesat dhe produktet tjera financiare moderne dhe sa prej tyre kanë ndryshuar sjelljen si rezultat i informacionit që ju është ofruar.

vii) Ekonomia e shkallës në SKP duke shfrytëzuar rastet e përdorimit të pagesave me vëllim të madh

Kalimi i kryerjes së pageave dhe arkëtimit të hyrave të qeverisë në forma elektronike

109. **Pasi llogaritë e pagesave ose të transaksioneve (përfshirë llogaritë e parave elektronike), duke filluar nga janari 2020, janë të lejuara të ofrohen edhe nga ofruesit tjerë të shërbimeve të pagesave përveç bankave (sic janë IFJB-të e autorizuar për shërbimet e pagesave dhe emetimit të parasë elektronike), ato do të përdoren gjithashtu për shpërndarjen e pensioneve dhe skemave të benefiteve tjera sociale në afat të mesëm, pasi të arrijnë të jenë interoperabile me llogaritë bankare.** Transferimi i shpërndarjes së këtyre pagesave përmes llogarive të pagesave është më kompleks se sa pagesat tjera të qeverisë (p.sh.: pagat), për arsye të nivelit të ulët të të ardhurave të përfituesve të tyre, posedimit të ulët të llogarive dhe nivelit më të ulët të edukimit financiar dhe digjital në përgjithësi. Prandaj, përveç koston më të ulët, këto llogari do të jenë të qasshme/përdorueshme përmes disa llojeve të kanaleve që ofrohen edhe në formë virtuale dhe fizike. Për më tepër, këto llogari do të jenë si produkte bazike (psh.: për qëllime të ndryshme dhe interoperabile me produktet tjera të bankave dhe me kanale/pika të ndryshme të qasjes). Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme që përdoruesve të ju ofrohet mundësia për të zgjedhë se me cilin ofrues të shërbimeve dëshirojnë të ju qasen fondeve të tyre. Përfituesit mund të zgjedhin ofruesin e shërbimeve të pagesave duke u bazuar në preferencat e tyre apo përshtatshmërinë ndaj nevojave të tyre, pasi që përfituesit kanë kërkesat e tyre specifike dhe janë kryesorët që duhet të vendosin se cili ofrues i shërbimeve ju ofron qasje më të përshtatshme nga shtëpia apo nga puna, varësisht nga nevojat e tyre.

110. **Çdo barrier ligjore apo rregullative për mbledhjen e pagesave elektronike të qeverisë nga IFJB-të do të eliminohet.** Mbledhja e të hyrave të institucioneve publike (pagesat P2G dhe B2G) mund të përfitojë nga modelet inovative të biznesit, si dhe kanalet elektronike dhe online që shmangin nevojën për tu paraqitur në degën e bankës apo ambientet e agjencisë së caktuar qeveritare.

Shfrytëzimi i rolit të faturuesve të mëdhenj dhe pagesave të transportit

111. **Marrë parasysh situatën aktuale të dominimit të parasë së gatshme për arkëtimet e faturave të shërbimeve publike dhe pagesave të transportit, do të ndërmerren veprime për të dekurajuar përdorimin e parave të gatshme dhe për të nxitur alternativat e pagesave elektronike.** BQK i rekomandon Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve që të shqyrtojë mundësitë e zbritjes së TVSH-së për blerjet e kryera me mjete elektronike, përfshirë pagesën e faturave. Gjithashtu, BQK i rekomandon faturuesve të mëdhenj dhe komunave të cilat ofrojnë shërbimet e transportit që të bashkëpunojnë në nxitjen e përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave, të cilat mund të zvogëlojnë shpenzimet e tyre të arkëtitimit. Faturuesit duhet të shqyrtojnë ofrimin e zbritjeve dhe/ose stimujve tjerë nëse faturat shlyhen përmes debitimit direkt. Ata gjithashtu duhet të përgatisin fushata edukimi për klientët, punonjësit e tyre dhe autoritetet lokale, për të sqaruar se faturat e paguara në mënyrë elektronike janë ligjrisht të vlefshme dhe nuk kërkojnë konfirmim/dëshmi në letër. Po ashtu, në momentin që pagesat elektronike mund të pranohen prej tyre, komunat që administrojnë shërbimet e transportit do të shqyrtojnë mundësitë e zbritjes së çmimeve për përdoruesit që paguajnë rregullisht në mënyrë elektronike.

viii) Mbikëqyrja efektive e tregut të pagesave me vlerë të vogël nga BQK

112. **BQK do të rishikoj kornizën e saj të politikave të mbikëqyrjes për ta sjellë atë në pajtueshmëri me standardet më të mira ndërkombëtare (psh. me parimet e përgjithshme për mbikëqyrje efektive – IOSCO/CPMI) dhe për të përfshirë shërbimet e pagesave.** Kjo kërkon p.sh. përfshirjen e kriterëve të klasifikimit të sistemeve të pagesave dhe definimit më të mirë të fushëveprimit të mbikëqyrjes duke marrë në konsideratë infrastrukturën tjera të tregut financiar, si dhe bashkëpunimit me njësitë tjera, siç janë departamenti i mbikëqyrjes lidhur me shërbimet dhe instrumentet e pagesave.
113. **Përveç metodologjisë së saj për vlerësimin e sistemeve të pagesave të rëndësisë sistemike, BQK do të hartoj metodologjinë për vlerësimin e sistemeve të pagesave me vlerë të vogël përfshirë këtu ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe operatorët e sistemeve të pagesave.** Kjo do të përfshij të gjithë hapat e nevojshëm të kryerjes së procesit të mbikëqyrjes, parimet e aplikueshme dhe bashkëpunimin brenda BQK-së dhe me autoritetet tjera relevante, në rastet kur është e nevojshme.
114. **BQK si nga perspektiva e mbikëqyrjes prudenciale edhe nga aspekti i mbikëqyrjes së sistemit të pagesave, do të sigurohet që ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe operatorët e sistemeve të pagesave, rishikojnë në baza të rregullta strukturën e kostove dhe çmimeve të shërbimeve të tyre dhe se i shmangin praktikën abuzive të vendosjes së çmimeve.** BQK do të mbaj kontakt të afërt dhe të vazhdueshëm me tregun në mënyrë që të monitoroj politikën e çmimeve dhe të kujdeset për praktikën jo të drejtë. BQK nuk do të lejoj praktikën e padrejtë të çmimeve për shërbimet e infrastrukturës (psh. përfshirë këtu tarifën e shkëmbimit në tregun e pagesave me kartelë). Për të nxitur më tepër transparencë në

vendosjen e çmimeve, do të bindë ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe operatorët e sistemeve të pagesave të shmangen nga vendosja e çmimeve më të larta për një grup të konsumatorëve duke subvencionuar çmime më të ulëta për një grup tjetër.

115. **BQK dhe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës do të monitorojnë për së afërmi dhe do të marrin masa ndaj çdo praktike kundër konkurrencës së shëndoshë në tregun e pagesave me vlerë të vogël.** Në veçanti, do të monitorojnë çdo veprim nga pjesëmarrësit e tregut që ka për qëllim mos ofrimin, pengimin ose kufizimin e qasjes ndaj shërbimeve që përfshijnë konkurrentët. BQK, në përputhje me mandatin dhe përgjegjësitë e saj ligjore, do të ndërmarr të gjitha veprimet për mbrojtjen e konkurrencës në shërbimet e pagesave me vlerë të vogël. Kur është e nevojshme, çështjet e konkurrencës do të adresohen te Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, për veprime të mëtejme ligjore.
116. **Me transpozimin e Direktivës PSD2 përmes Ligjit të ri të Sistemit të Pagesave, BQK do të siguroj që kontratat që përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e ofruesve dhe të përdoruesve të shërbimeve të pagesave, janë të definuara qartë dhe zbatohen drejtë.** Këto përfshijnë aspekte si mënyra se si autorizohen dhe ekzekutohen transaksionet, koha maksimale e ekzekutimit dhe data e vlefshmërisë së pagesës, revokimi i urdhërpagesave, përgjegjësitë në rastet e përdorimit të paautorizuar të instrumenteve të pagesave, si dhe kthimet dhe rimbursimet e pagesave.
117. **BQK ka përcaktuar me rregullore mbajtjen dhe publikimin e një regjistri me agjentët e përdorur nga bankat dhe ofruesit tjerë të shërbimeve të pagesave.** BQK do të siguroj që ky regjistër mirëmbahet dhe përditësohet në baza periodike, si dhe i njëjti publikohet për konsumatorët.

III. ZBATIMI I STRATEGJISË KOMBËTARE TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL: ROLET, PËRGJEGJËSITË DHE MONITORIMI I PROGRESIT

III.1. Rolet dhe Përgjegjësitë

118. Zbatimi i suksesshëm i strategjisë kërkon caktimin e roleve dhe përgjegjësive specifike ndaj akterëve të ndryshëm, sipas rregullave të përgjegjësive publike.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

119. BQK është një aktor kritik në zbatimin e SKPVV-së. BQK do të luaj një rol shumë aktiv në promovimin e SKPVV-së duke mbështetur bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet aktorëve, si dhe duke promovuar veprime të përbashkëta nga aktorët kurdo që është e nevojshme. Në kapacitetin e saj shumë dimensional lidhur me pagesat si bankë qendrore, BQK do të:

- i. Nxisë reformat dhe masat zhvillimore për pagesat me vlerë të vogël, kryesisht duke nxitur veprime dhe vendime bashkëpunuese nga sektori privat dhe subjektet relevante të sektorit publik;
- ii. Hartojë ligje dhe rregullore (ose ndryshimin e tyre), si dhe dokumente strategjike;
- iii. Mbikëqyrë tregun e pagesave me vlerë të vogël dhe më gjerësisht sistemin kombëtar të pagesave – SKP, për të siguruar funksionimin e mirë të tyre;
- iv. Siguroj kliringun, shlyerjen dhe infrastrukturë përcjellëse përmes operimit të Sistemit Ndërbankar të Pagesave, duke përfshirë edhe shlyerjen finale dhe pakthyeshmërinë e pagesave të kryera në para të bankës qendrore, duke rritur kështu besueshmërinë në sistemin e pagesave; dhe
- v. Përdorë infrastrukturë, instrumente dhe shërbime moderne të pagesave për aktivitetet e veta të pagesave dhe në emër të klientëve të saj institucional dhe konsumatorëve.

Shoqata e Bankave të Kosovës

120. SHBK si institucion që përfaqëson bankat e Kosovës, do të:

- i. Koordinoj dhe përfaqësoj interesat e anëtarëve të saj për çdo çështje që ka të bëjë me SKPVV-në, duke përfshirë por mos u kufizuar në, hartimin dhe prezantimin e produkteve të reja të pagesave në të gjithë industrinë bankare dhe në edukimin financiar;
- ii. Nxit dhe koordinoj incentivat për të krijuar infrastrukturë të pagesave me vlerë të vogël me pronësi private, duke nxitur intergrimin e tyre me infrastruktura të tjera (psh ATS);
- iii. Hartoj dhe adaptoj standarde në të gjithë industrinë bankare (dhe me ofrues të tjerë të shërbimeve të pagesave) për të siguruar njëtrajtshmërinë dhe efikasitetin e operacioneve; dhe,
- iv. Nxit dhe lehtësoj ndërveprimin e të gjitha llogarive bankare, pikave të qasjes dhe ndërmjet llogarive bankare dhe llogarive të parave elektronike.

Këshilli Kombëtar i Pagesave

121. Për sa i përket zbatimit të SKPVV-së, KKP do të përfshihet kryesisht në monitorimin e progresit.

Në këtë kontekst, Këshilli do të:

- i. Lehtësoj komunikimin ndërmjet akterëve të sektorit publik dhe atyre të sektorit privat;
- ii. Identifikoj dhe rekomandoj zgjidhje për çështje të ndryshme të ngritura të cilat janë në interesin e përbashkët të gjithë pjesëmarrësve;
- iii. Monitoroj dhe raportoj në bashkëpunim me BQK lidhur me progresin në zbatimin e SPKVV-së dhe veprimeve të ndërmarra nga anëtarët e tij.

Agjencitë dhe Institucionet tjera Qeveritare

122. Agjencitë e ndryshme qeveritare mbajnë gjithashtu role dhe përgjegjësi të rëndësishme të cilat bartin përgjegjësi rregullative në fusha që kanë ndërlidhje të ngushta me fushëveprimin e SKPVV-së. Këto përfshijnë agjencitë rregullatorë të TIK, telekomunikacionit, konkurrencës, mbrojtjes së konsumatorit, punës dhe mirëqenjes sociale, etj.

123. Subjekte tjera qeveritare të cilat kanë role të rëndësishme në kontekst të SKPVV-së janë Thesari/Ministria e Financave Punës dhe Trasfereve, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Agjencioni i Regjistrimit Civil, Agjencioni i Shoqërive Informativë, si dhe Njësia e Inteligjencës Financiare.

Ofruesit e Shërbimeve të Pagesave (bankat dhe IFJB-të)

124. Ofruesit individual të shërbimeve të pagesave do të:

- i. Angazhohen për transparencë në ofrimin e shërbimeve të pagesave ndaj klientëve të tyre dhe për mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve gjatë kryerjes së shërbimeve të pagesave për klientët (individët, bizneset të cilat mbajnë llogari me këta ofrues të shërbimeve, si dhe tregtarët në arkëtimin e pagesave përmes tyre dhe subjektet qeveritare);
- ii. Menaxhojnë në mënyrë strikte rreziqet e lidhura me shërbimet e pagesave që i ofrojnë për publikun, si dhe operacionet e pagesave të tyre në përgjithësi; dhe,
- iii. Adaptojnë drejtimin strategjik për tregun e pagesave me vlerë të vogël të aprovuar nga BQK dhe në kuadër të KKP dhe kontribuojnë aktivisht në dialogun e politikëbërjes mbi çështjet e lidhura me SKP.

Operatorët e Sistemeve të Pagesave dhe skemave të kartelave / parave elektronike

125. Operatorët individual të sistemeve të pagesave dhe skemave të kartelave / parave elektronike do të:

- i. Ndjekin praktika që nxisin ndërveprimin dhe bashkëpunimin, për krijimin e standardeve, infrastrukturave/shërbimeve dhe veprimeve të përbashkëta kurdo që është e nevojshme;
- ii. Respektojnë standardet ndërkombëtare për menaxhimin e rrezikut dhe angazhohen në ndjekjen e rregullave dhe standardeve të përcaktuara nga BQK apo autoritetet tjera

relevante, përmes të cilave mund të rritet niveli i efikasitetit dhe efektivitetit në shërbimin e nevojave të tregut;

- iii. Ruajnë dhe përmirësojnë një politikë të hapur, të drejtë dhe të bazuar në rrezik për ofrimin e qasjeve ndaj institucioneve individuale; dhe,
- iv. Adaptojnë drejtimet strategjike për tregun e pagesave me vlerë të vogël, të aprovuara nga BQK dhe në kuadër të KKP. Si dhe kontribuojnë aktivisht në dialogun e politikëbërjes rreth çështjeve të SKP.

Shoqatat e Industrisë dhe Organizatat e Shoqërisë Civile

126. Shoqatat e industrisë dhe organizatat e shoqërisë civile, përfshirë shoqatat e përdoruesve (kur janë të aplikueshme) do të angazhohen në çështje specifike, në pajtim me objektivat dhe përgjegjësitë e tyre staturore dhe me kërkesë të KKP-së, për mbështetjen e zbatimit të strategjisë dhe përfitimit të përkrahjes nga akterë relevant.

III.2. Monitorimi i Progresit

127. **Në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të progresit në zbatimin e SKPVV-së, do të zhvillohet një kornizë që në fillim si pjesë intergrale e planit të përgjithshëm të zbatimit të saj.** Progresi në zbatimin e SKPVV-së do të vlerësohet në baza periodike kundrejt vizionit dhe objektivave kryesore të matshme të vendosura në fillim të adaptimit të SKPVV-së. Një numër i “variablave të ndërmjetme” të cilat pasqyrojnë progresin drejtë vizionit dhe objektivave kryesore do të maten/llogariten dhe monitorohen në vazhdimësi. Kjo do të ndihmojë për të identifikuar menjëherë kërkesat për korrigjim të drejtimit dhe aktiviteteve të caktuara.
128. **Në këtë drejtim, objektivat kryesore të SKPVV-së janë:**
 - i. **Rritja e numrit aktual të pagesave jo-cash për kokë banori në 25 pagesa të tilla deri në fund të vitit 2026. Pika fillestare është 17.3 pagesa jo-cash për kokë banori të marra në fund të vitit 2019.**
 - ii. **Arritja e posedimit të llogarive nga personat e moshës madhore në raportin prej 70% deri në fund të vitit 2026. Pika fillestare është 52% e personave të moshës madhore posedojnë llogari bankare me të dhënat e fundit të vitit 2017.**
129. **BQK do të matë këto variabla të objektivave kryesore një herë në vit dhe do ti raportoj ato në KKP, i cili pastaj do të vlerësoj progresin përkatës ose veprimet që vlerësohet e nevojshme të ndërmerren. BQK do të komunikoj progresin e arritur për publikun e gjerë.**
130. **Në anën tjetër, BQK do të zgjedhë disa variabla të ndërmjetme të cilat do ti llogarisë së paku për çdo tremujor, në përpjekje që të identifikoj trendet sa më herët që është e mundur. Këto llogaritje do të raportohen në KKP dy herë në vit.**
131. **Në këto raporte, BQK do të identifikoj bazën fillestare të secilit tregues/variabël, drejtimin e pritur (p.sh. nëse do të ketë trend rritës apo zvogëlues në mënyrë që të jetë në pajtim me objektivat kryesore) të tyre për atë muaj dhe krahasimin me bazën fillestare (ndryshimet në vlerë absolute dhe normë të rritjes/zvogëlimit).**

Tabela 7. Variabla të ndërmjetme për vlerësimin e progresit të zbatimit të SKPVV-së

Variabla të ndërmjetme	Sqarime
Pikat e qasjes	Kjo do të përfshijë matës të tillë si терминаlet ATM dhe POS për 1,000 banor dhe numrin e degëve për 1,000 banorë. Për të pasur një vlerësim më të saktë, mund të zhvillohet një matës për zona gjeografike specifike (rajoni, zona urbane kundrejt atyre rurale) etj.).
Matës tjerë të qasjes Ky grup matësish ndihmojnë për të vlerësuar penetrimin e instrumenteve të pagesave dhe kanaleve alternative të qasjes.	Këto mund të përfshijnë matës si numri i kartelave të kreditit dhe debitit për kokë banori, pjesa e llogarimbajtësve të regjistruar në shërbimin bankar përmes internetit dhe/ose telefonit mobil; pjesa e llogarimbajtësve që përdorin shërbimin bankar përmes internetit dhe/ose telefonit mobil një herë në muaj; numrin e llogarive me para elektronike; numrin dhe volumin e pagesave me instrumente të parave elektronike, etj.
Transaksionet për terminal ATM dhe POS, e-Commerce	Ky është numri i transaksioneve për ATM, POS apo infrastrukturë tjetër për pranimin e pagesave elektronike gjatë një periudhe të caktuar kohore. Kjo shërben për të matur nivelin e ndërveprimit dhe përdorimit të infrastrukturës.
Transaksione në POS/ Transaksione në ATM	Ky numër reflekton evolucionin në përdorimin e kartelave të pagesave si instrumente pagese elektronike me tregtarët, kundrejt përdorimit të tyre si mekanizëm shpërndarës i parave të gatshme (p.sh. ATM-të)
Perqindja e urdhëresave të pranuar nga Ofruesit e Shërbimeve të Pagesave vetëm përmes mjeteve elektronike	Kjo është pjesa e instruksioneve të pagesave të marra nga Ofruesit e Shërbimeve të Pagesave, nëpërmjet mjeteve elektronike, kundrejt totalit të numrit të instruksioneve të pagesave (duke përfshirë kanalet elektronike, në formë fizike me letër dhe kontaktet e drejtëpërdrejta).
Perqindja e urdhërpagesave të pranuar dhe të procesuara nga Ofruesit e Shërbimeve të Pagesave vetëm në formë elektronike	Si më sipër, megjithëse ky variabël gjithashtu përfshin nëse instruksionet e pagesave u përpunuan elektronikisht, pasi u morrën në formë elektronike (d.m.th. për të identifikuar/matur evolucionin në procesimin e drejtëpërdrejtë të pagesave – straight-through processing)
Volumi dhe vlera e mashtrimeve dhe gabimeve operacionale.	Ky është numri dhe vlera e mashtrimeve, përfaqësuar në përqindje për kategori specifike mashtrimesh dhe gabimesh operacionale, si: përpunimi i vonuar i transferimit të fondeve; debitimi i një llogarie të gabuar apo mashtrime dhe/apo falsifikime, mashtrime lidhur me reputacionin, etj.

Burimi: Adaptuar nga Banka Botërore (2012), "Zhvillimi i një strategjie gjithëpërfshirëse kombëtare të pagesave me vlerë të vogël".

III.3. Plani i implementimit

Tabela 8. Plani i implementimit të SKPVV-së në Kosovë

Fusha strategjike	Veprimet	Entiteti/njësia kryesore implementuese	Periudha kohore (2021-2026)
Përforcimi i angazhimit të pjesëmarrësve	Zgjerimi i anëtarësisë së KKP-së për të përfshirë anëtarë me të drejtë vote (IFJB-të dhe ofrues tjerë të shërbimeve të pagesave) që mund të kontribuojnë në dialogun rreth objektivave të KKP-së	BQK për koordinim	2021
	Një rol më aktiv dhe i dukshëm i KKP-së në kontekstin e SKPVV-së: 1. Krijimi i një grupi punues për pagesat me vlerë të vogël në kuadër të KKP-së për monitorimin e progresit të SKPVV-së; 2. Krijimi i një grupi punues për të siguruar që burimet për avancimin e përpjekjeve për rritjen e përfshirjes financiare janë të koordinuara në mënyrë efektive.	Anëtarët e KKP-së, me mbështetjen e BQK-së (si Sekretariat)	2021 - punë në vazhdimësi
	Promovimi sa më i madh i përfshirjes së sektorit privat në vendimet me interes të përbashkët dhe rëndësi publike, për sa i përket tregut kombëtar të pagesave me vlerë të vogël	BQK dhe anëtarët e KKP-së	Fillimi në 2021 dhe në vazhdimësi
	Shfrytëzimi i burimeve për asistencë teknike nga ekspertë të jashtëm, agjencione të specializuara, apo homolog nga vendet tjera, për adresimin e sfidave të SKPVV-së	BQK dhe SHBK	Fillimi në 2021 dhe në vazhdimësi
Konsolidimi i një mjedisi ligjor dhe rregullativ lehtësues për pagesat me vlerë të vogël	Finalizimi i përafrimit të legjislacionit të vendit me Direktivate e BE-së: <ul style="list-style-type: none"> PSD-2 – Shërbimet e pagesave EMD - Institucionet e Parasë Elektronike Settlement Finality Directive – Direktiva për shlyerjen finale të pagesave Payment Account Directive - Mbi llogaritë e pagesave 	BQK dhe Qeveria	2021-2026
	Rishikim i vazhdueshëm i kornizës ligjore dhe rregullative për tregun e Kosovës për pagesat me vlerë të vogël	BQK, SHBK dhe përfaqësues të IFJB-ve	Në vazhdimësi
	Sigurimi i konsistencës së dispozitave mbi transparencën dhe mbrojtjen e konsumatorit që rrjedhin me adaptimin e Direktivës së BE-së PSD2	BQK	2021-2024
	Rregullimi në mënyrë konsistente i përdorimit të shërbimeve të kontraktuara nga palët e treta në sektorin e pagesave, me fokus të veçantë në përdorimin e ofruesve të shërbimeve teknike	BQK	2021-2023
Aprovimi dhe implementimi i ligjit mbi "Identifikimin elektronik dhe vendosjes së besimit për transaksionet elektronike"	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	2021-2022	

Fusha strategjike	Veprimet	Entiteti/njësia kryesore implementuese	Periudha kohore (2021-2026)
	Shqyrtimi i mundësive të aplikimit të masave të thjeshtësuara të PPT/LFT-së në rastet e instrumenteve të parave elektronike	MF/NJIF, BQK	2021-2022
Përmirësime në infrastrukturën e pagesave dhe infrastruktura tjera	Shqyrtimi i mundësive të adaptimit të infrastrukturës së nevojshme për mundësimin e pagesave të shpejta "Instant Payments".	BQK	2021-2025
	Rritja e përdorimit të infrastrukturës ekzistuese të debitimit direkt në kuadër të modulit ACH.	KKP, BQK, Bankat, Kompanitë e shërbimeve publike	Në vazhdimësi
	Rregulloret dhe rregullat tjera të gjitha infrastrukturave të pagesave në vend do të garantojnë qasje të hapur. Ku është e nevojshme do të iniciohen reforma ligjore.	BQK	Në vazhdimësi
	Zgjerimi i kategorisë së pjesëmarrësve direkt në SPN përfshirë edhe IFJB-të e autorizuara për shërbimet e pagesave dhe emetimin e parave elektronike	BQK	2021-2023
	Kolateralizimi në avans i pozicioneve debitore neto të pjesëmarrësve në modulën e ACH-së.	BQK	2021-2022
	Shqyrtimi i vendosjes së kufizimeve pozicionet debitorë neto të pjesëmarrësve në ACH.		
	Vlerësimi i detajuar i SPN-së bazuar në Parimet e nxjerra nga CPMI-IOSCO: <ul style="list-style-type: none"> Përgatitja e një raporti të detajuar të vetëvlerësimit; Kryerja e një vlerësimi të jashtëm. 	BQK dhe vlersësues të jashtëm	Të finalizohet gjatë 2021-2024
	Kërkesa ndaj sistemeve të pagesave të operuara nga sektori privat të zbatojnë masa strikte të menaxhimit të rrezikut në kuadër të rregullimeve të tyre për kliring dhe shlyerje të pagesave.	BQK	2021 dhe në vazhdimësi
Adresimi i çështjeve që kanë të bëjnë me rrezikun ndaj sigurisë kibernetike dhe ndërmarrja e masave të nevojshme	BQK, ofruesit e shërbimeve të pagesave	2021 dhe në vazhdimësi	
Ofrimi i instrumenteve të pagesave të koncentruara te klienti dhe kërkesat e tij, si dhe të përballeshme financiarisht	Dizajnimi dhe ofrimi i një produkti llogarie "bazike" për transaksione për persona që aktualisht nuk posedojnë llogari bankare.	Bankat, IFJB-të e autorizuara për ofrimin e shërbimeve të pagesave me mbështetje të SHBK-së dhe BQK-së	2021-2022
	Sigurimi i llogarive të përballeshme përmes një strukture të përshtatshme të çmimeve.		
	Llogaritë bazike do të bëjnë të mundur për përdoruesit të paguajnë (dhe paguhen) në mënyrë elektronike drejtë/nga sa më shumë palë të mundshme.		
	Ri-dizajnim i strukturës së çmimeve ekzistuese për llogaritë rrjedhëse për të shtyrë më shumë individë dhe biznese të vogla në hapjen dhe përdorimin më të madh të llogarive dhe instrumenteve të pagesave elektronike që mundësojnë ato (në vend të parave të gatshme).	Bankat, IFJB-të e autorizuara për ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe emetimin e parave elektronike	2021-2022
Për aq sa është e mundur, shpenzimet paraprake për hapjen e një llogarie dhe tarifave të detyrueshme të mirëmbajtjes mujore ose vjetore të zvogëlohen.			
Përgatitja e bazës së të dhënave me çmimet e produkteve dhe shërbimeve financiare dhe publikimi i saj përmes faqes së BQK-së në internet, për ta bërë më të përdorshme nga përdoruesit ekzistues dhe të rinjë.	BQK, bankat, IFJB-të	2021-2022	

Fusha strategjike	Veprimet	Entiteti/njësia kryesore implementuese	Periudha kohore (2021-2026)
Zgjerimi i pikave të qasjes dhe rrjetit të pagesave	Zhvillimi i modelit të bankingut përmes agjentëve.	Bankat, IFJB-të	2021 dhe në vazhdimësi
	Arritja e ndërveprimit midis kanaleve të ndryshme nëpërmjet një sistemi të mundshëm për mundësimin e pagesave të shpejta.	BQK, Bankat dhe IFJB-të	2021 dhe në vazhdimësi
	Analizimi i mundësive për ofrimin e stimuljeve ekonomik të përkohëshëm dhe / ose incentivave fiskale ndaj tregtarëve për pranimin e pagesave elektronike ose pagesat e faturave.	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve	2021-2022 2022-2023
	Zbatimi i masave të tilla nëse vlerësohet e mundshme.		
	BQK do ju kërkoj bankave të cilat janë pranues të pagesave me kartela "acquirers" që: <ul style="list-style-type: none"> Të bëjnë transparente tarifat që aplikojnë ndaj tregtarëve; Të ofrojnë këtë lloj informacioni në një formë standarde për tregtarët. 	BQK	2021-2022
Mbledhë të dhëna statistikore për tarifat e ngarkuara nga pranuesit e pagesave, me kartelë dhe instrumente tjera elektronike, ndaj tregtarëve dhe përfshij këto të dhëna në databazën e BQK-së për shërbimet financiare (të referuar më lartë).	BQK	2022-2023	
Përmirësimi i efikasitetit të përpjekjeve për edukim financiar	Zhvillimi i mesazheve bindëse për shpjegimin e përfitimeve që i sjellë Kosovës zbatimi i SKPVV-së	BQK, SHBK dhe KKP	2021-2026
	Intensifikimi i përpjekjeve për të edukuar qytetarët e Kosovës mbi përdorimin e llogarive të transaksioneve dhe pagesave elektronike, nëpërmjet rritjes së informimit dhe ofrimit të informatave me fokus kategori të caktuara.	BQK, SHBK, entitetet tjera publike dhe IFJB-të	2021 dhe në vazhdim
	Ofrimi i trajnimeve praktike për klientët gjatë procesit të shitjes së produkteve.	Bankat dhe IFJB-të që ofrojnë shërbime pagesash	2021 dhe në vazhdim
	Aktivizimi i e-Portalit të qeverisë për ofrimin e shërbimeve online dhe ngritja e vetëdijes së publikut lidhur me mënyrën dhe efektivitetin e përdorimit të tij, sa më gjerërisht që është e mundur (p.sh.: përdorimi i kartës së identitetit për qasje në portal dhe përfshirja e pagesës online). Rritja e numrit dhe llojeve të shërbimeve publike që ofrohen përmes këtij portali, si dhe pagesave P2G dhe B2G që mund të realizohen online përmes e-Portalit.	Ministria e Administratës Publike, Agjencioni për Shoqëritë e Informacionit Ministria e Zhvillimit Ekonomik Thesari / Ministria e Financave Punës dhe Transfereve	2021 dhe në vazhdim
	Matja objektive e efektivitetit të përpjekjeve të edukimit financiar dhe programeve të deritanishme të ndërmarra nga BQK, SHBK dhe entitetet tjera.	BQK , SHBK, Autoritete tjera	2021 dhe në vazhdim
Të arrihet ekonomia e shkallës shfrytëzuar programet e	Llogaritë e pagesave (përfshirë këtu llogaritë e parave elektronike), do të përdoren edhe për shpërndarjen e pensioneve dhe të skemave tjera të përfitimeve sociale në afate të mesëm, pas adaptimit të kornizës së nevojshme ligjore dhe arritjes së interoperabilitetit të tyre me llogaritë bankare.	BQK, Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale	2021-2022

Fusha strategjike	Veprimet	Entiteti/njësia kryesore implementuese	Periudha kohore (2021-2026)
pagesave me vëllim të madh	Eliminimi i barrierave ligjore apo rregullative për mbledhjen e pagesave për qeverinë nga ana e IFJB-ve	Thesari / Ministria e Financave Punës dhe Transfereve; Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale dhe BQK	2021-2022
	Të shqyrtohet mundësia e zbritjeve dhe / ose stimujve tjerë për faturat që paguhen përmes debitimit direkt apo formave elektronike.	Faturuesit e mëdhenj (shërbimet komunale, telekomit, etj)	2021-2022
	Pasi të jenë të gatshme të pranojnë pagesat në formë elektronike, Komunitat të cilat menaxhojnë shërbimet e transportit mund të ofrojnë zbritje për përdoruesit që paguajnë përmes instrumenteve të pagesave elektronike	Komunitat	2021-2022
	Faturuesit e mëdhenj të zhvillojnë fushata edukuese përmes së cilave të ju konfirmohet qytetarëve validiteti i pagesave elektronike dhe përfitimet në rast të zbritjeve të ofruara për këto pagesa.	Faturuesit e mëdhenj	2021 dhe në vazhdim
Mbikëqyrja efektive e tregut të pagesave me vlerë të vogël nga BQK	Të rishikohet korniza e politikës së mbikëqyrjes nga BQK për ta avancuar atë në pajtim me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare (p.sh.: Parimet e përgjithshme të mbikëqyrjes efektive) dhe të përfshihet mbikëqyrja e shërbimeve të pagesave me vlerë të vogël.	BQK	2021-2023
	Të avancohet mbikëqyrja e shërbimeve të pagesave duke përdorur qasjen e bazuar në rrezik.		
	Fuqizimi i bashkëpunimit me Departamentin e Mbikëqyrjes.		
	Përgatitja e metodologjisë për vlerësimin e institucioneve që ofrojnë shërbime të pagesave me vlerë të vogël.	BQK	2022-2023
	Të sigurohet që ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe operatorët e sistemeve të pagesave rishikojnë në baza të rregullta strukturën e kostos dhe çmimeve të shërbimeve të tyre.	BQK	2021 dhe në vazhdim
	Të sigurohet që ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe operatorët e sistemeve të pagesave evitojnë praktikën e padrejta dhe jo-transparente të vendosjes së çmimeve (përmes ekzaminimeve dhe mbledhjes së të dhënave nga distanca, në kuadër të procesit të mbikëqyrjes).	BQK	2021 dhe në vazhdim
	BQK dhe Autoriteti i Konkurrencës do të bashkëpunojnë kundër çdo praktike anti-konkurrencë në tregun e pagesave me vlerë të vogël.	Autoriteti i Konkurrencës në bashkëpunim me BQK	2021 dhe në vazhdim
	Të sigurohet që kontratat që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet, si për ofruesit e shërbimit dhe përdoruesit, të jenë të qarta dhe të zbatohen drejtë.	BQK, bankat, IFJB-të	2021 dhe në vazhdim
Të mbahet një regjistër i agjentëve të përdorur nga bankat dhe IFJB-të.	BQK	2021	
Ky regjistër të jetë publik dhe në dispozicion të konsumatorëve.	BQK	2021	
VEPRIMET TJERA: ZBATIMI I MONITORIMIT TË PROGRESIT			

Fusha strategjike	Veprimet	Entiteti/njësia kryesore implementuese	Periudha kohore (2021-2026)
Monitorimi i progresit	Matja e objektivave kryesore/variablove të përcaktuara me SKPVV-së (p.sh.:pagesat elektronike –jocash për kokë banori dhe përqindja e posedimit të llogarive nga qytetarët e moshës madhore) Komunikimi i progresit të arritur me këta tregues/variable për publikun e gjerë.	BQK dhe KKP	Një herë në vit
	Përzgjedhja dhe matja e “variablove të ndërmjetme” që përcjellin ecurinë drejtë vizionit dhe objektivave gjithëpërfshirëse të dakorduara. Raportimi i rezultateve për KKP-në për çdo gjashtë muaj. KKP të ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e progresit të pamjaftueshëm	BQK KKP KKP	Çdo gjashtë muaj Në vazhdimësi

Shtojca 1. Fjalor i termave të përzgjedhur³³

Kriteri i qasjes (ose hyrjes)	Kriter për të qenë pjesëmarrës i drejtpërdrejt në një sistem pagesash, zakonisht i përcaktuar në rregullat e atij sistemi.
Pikë e qasjes	Një pikë që është e nevojshme për të inicuar një pagesë. Pikat e qasjes mund të përfshijnë: zyrat e degëve; ATM-të; terminalët POS; apo një aparat personal të përdoruesit (për qasje nëpërmjet internetit apo një rrjeti tjetër telekomunikimi).
Agjent bankar	Marrëveshje biznesi të bankave dhe IFJB-ve si ofrues të shërbimeve që përdorin subjekte lokale (d.m.th. agjentë) si zyra të vogla për të ofruar shërbime bazë dhe transaksione të lidhura me llogarinë në emër të tyre. Në disa raste, kjo marrëveshje quhet edhe shërbim financiar nëpërmjet një agjenti.
Agjent	Një subjekt që ofron shërbime pagesash në emër të një ofruesi shërbimesh pagesash. Lloji i shërbimit i ofruar nga agjenti mund të ndryshojë nga prapuni i drejtpërdrejt i transaksioneve si, disbursimi i parave të gatshme ose marrja e depozitave për llogaritë, shërbime ndihmëse të lidhura me transaksione të tilla si mbledhja e dokumenteve, hapja e një llogarie (llogari bankare, llogari e parave elektronike si kuleta digjitale apo llogari e pagesave) ose shërbimi i adresimit të pyetjeve të klientit.
Bankomat (Automated Teller Machine-ATM)	Një aparat elektromekanik që u lejon përdoruesve të autorizuar, tipikisht duke përdorur karta pagesash të lexueshme nga makina, të tërheqin para nga llogaritë e tyre dhe/ose të përdorin shërbime të tjera si nxjerrje bilanci, transferime fondesh ose depozitime. ATM-të mund të operohen online, me akses në kohë reale në një bazë të dhënash autorizimi, ose offline. Ato mund të gjenden në degët e OSHP-ve ose në lokacione tjera.
Dega	Vendndodhja fizike e një OSHP-je që i lejon përdoruesve të tërheqin para nga llogaritë e tyre dhe/ose të përdorin shërbime të tjera si nxjerrje bilanci, transferime fondesh ose depozitime. Këto veprime mund të kryhen nëpërmjet sportelistit apo në zonën e vetëshërbimit të një OSHP-je.
Paraja e gatshme	Kartëmonedhat dhe monedhat e emetuara nga një bankë qendrore apo qeveri, të cilat njihen ligjërisht dhe kanë kurs ligjor në vendin që i ka emetuar.
Kliringu	Shkëmbimi i instruksioneve të pagesave ndërmjet bankës së paguesit dhe bankës së të paguarit (ose agjentit të tyre), rezultati i të cilës është llogaritja e detyrimeve të pagesave ndërmjet pjesëmarrësve të sistemit.
Shtëpi e kliringut	Një lokacion qendror ose një mekanizëm procesimi qendror, nëpërmjet të cilit institucionet financiare bien dakord të shkëmbejnë instruksionet e pagesave apo detyrime të tjera financiare (p.sh. letra me vlerë). Institucionet pranojnë zëra që shkëmbehen në një kohë të përcaktuar, në bazë të rregullave dhe procedurave të shtëpisë së klerimit. Në disa raste, shtëpia e klerimit mund të marrë përsipër përgjegjësi të rëndësishme për sistemin e klerimit për menaxhimin e rrezikut të kundërpalës, financiar, apo të administrimit.
Kartela e kreditit	Një tip kartele pagesash, që tregon që mbajtësit i është dhënë një linjë kredie. Kjo lejon mbajtësin të bëjë blerje dhe/ose të tërheqë para deri në limitin e paracaktuar; kredia e dhënë mund të shlyhet plotësisht në fund të një periudhe të përcaktuar ose të shlyhet pjesërisht, me bilancin e marrë si një kredi e zgjatur. Kamata paguhet në shumën e çdo kredie të zgjatur dhe mbajtësi mund të paguajë një tarifë vjetore. Një tip special kartele krediti është kartela mbushëse "a charge card". Një kartel mbushëse është një tip kartele pagesash që tregon që mbajtësit i është dhënë një linjë kreditore. Kjo lejon të bëjë blerje, por nuk i ofron një kredi të zgjatur, shuma e plotë e borxhit të krijuar duhet të shlyhet në fund të një periudhe specifike. Mbajtësi zakonisht ngarkohet me një tarifë vjetore. Shembuj të tyre janë kartelat e udhëtimit dhe zbavitjes.

³³ Përkufizimet janë marrur nga: "A Glossary of Terms Used in Payments and Settlement Systems", CPMI dhe "Developing a National Retail Payment Strategy", Banka Botërore.

Kartelë debiti	Kartë pagese ku fondet janë debituar në mënyrë të plotë për çdo transaksion. Lejon mbajtësin të kryejë blerje dhe/ose tërheqje para. Disa emetues të kartelave të debitit ofrojnë një mundësi mbitërheqje, duke lejuar paguesin të përdorë kartën edhe pa pasur gjendje të mjaftueshme në llogarinë bazë.
Transfer debitimi direkt	Një urdhër pagesë ose një sekuençë urdhërpagesash të bëra me qëllim për të mbledhur fonde nga paguesi dhe për t'i vënë në dispozicion të të paguarit. Instruksionet e pagesave kryesisht lëvizin nga ofruesi i shërbimit të pagesave (OSHP) i të paguarit/iniciuesit drejt OSHP-së së paguesit, ndoshta nëpërmjet disa OSHP-ve të tjera si ndërmjetëse dhe/ose më tepër se një sistem transferimi i debitimit direkt. Nëse si paguesi dhe i paguari janë klientë të të njëjtës OSHP-je, transferi i debitimit direkt mund të përpunohet pa pjesëmarrjen e OSHP-ve dhe/ose sistemeve të tjera të transfereve të debitimit direkt. Trasferet e debitimit direkt janë të kategorizuara si instrumente pagesash përmes transfereve elektronike të fondeve, megjithatë autorizimi (ose mandati) që përbën bazën kontraktore për (serinë e) transferin/et e debitimit direkt është ende shpesh herë i bazuar në letër.
Transfer kreditimi direkt	Një urdhërpagesë ose një sekuençë urdhërpagesash të bëra me qëllim për të vënë fonde në dispozicion të përfituesit. Si instruksionet e pagesave dhe fondet të përshkruara këtu, tipikisht, lëvizin nga OSHP-ja e paguesit/iniciuesit drejt OSHP-së së përfituesit, ndoshta nëpërmjet disa OSHP-ve të tjera si ndërmjetëse dhe/ose më shumë se një sistemi të transfereve të kreditimit direkt. Nëse si paguesi dhe i paguari janë klientë të të njëjtës OSHP-je, transferi i kreditimit direkt mund të përpunohet pa pjesëmarrjen e OSHP-ve dhe/ose sistemeve të tjera të transfereve të kreditimit direkt. Megjithëse transferet e kreditimit direkt, në thelb, kategorizohen si instrumente pagesash përmes transfereve elektronike të fondeve, ato mund të jenë një "instrument pagese hibrid", nëse inicohen me formularë letre. Si pjesë e procesit të kleringut, këta formularë letre zëvendësohen me shkëmbime të imazheve të tyre ose, më zakonisht, me zëvendësues digjitalë.
Pagesë tërësisht elektronike	Një instruksion pagese që inicohet në formë elektronike (p.sh. iniciuar në një sistem pagesash apo sistem bazikë bankar, nëpërmjet internetit apo një rrjeti tjetër telekomunikimi) dhe procesohet në formë elektronike në të gjithë hapat në vazhdim derisa llogaria e përfituesit të kreditohet përfundimisht (dhe llogaria e paguesit të jetë debituar). Pajisja e përdorur për të iniciuar pagesën mund të jetë një kompjuter, një celular, një terminal POS, apo ndonjë pajisje tjetër. Instrumenti i pagesave i përdorur është shpesh një produkt i kartelës së pagesave, transfer elektronike kredit/debit, produkt i parasë elektronike ose i pagesave të tjera inovative.
Pagesa të shpejta "Instant Payments"	Pagesat në të cilat transmetimi i mesazhit të pagesës dhe disponueshmëria e fondeve përfundimtare tek përfituesi ndodhin në kohë reale, përgjatë 24 orëve pa ndërprerë. Gjithashtu të njohura si "fast payments".
Ndërveprimi	Një situatë ku instrumente të pagesave që i përkasin një skeme të caktuar mund të përdoren në platforma të zhvilluara nga skema të tjera, duke përfshirë vende të tjera. Ndërveprimi kërkon përputhshmëri teknike ndërmjet sistemeve, por mund të hyjë në fuqi vetëm kur janë lidhur marrëveshje biznesore ndërmjet skemave në fjalë.
Rreziku i likuiditetit	Rreziku që një bankë nuk do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj për shlyerje (nevojë e përkohshme për fonde).
Bankingu përmes telefonit të mençur	Qasja në një llogari të mbajtur në një bankë, IFJB, apo një tjetër OSHP nëpërmjet një telefoni të mençur, për të marrë informacione mbi llogarinë dhe/ose për të iniciuar transaksione.
Para elektronike "në mobil"	Produkt i parasë elektronike ku regjistrimi i fondeve ruhet në telefon mobil apo në një sistem kompjuterik qendror, të cilat mund të përdoren nëpërmjet instruksioneve të pagesave specifike të emetuara nga bartësi i telefonit. Shpeshherë janë të njohura edhe si "para në mobil".

Sistem Kombëtar i Pagesave (SKP)	Përfshin gjithë aktivitetet, proceset, mekanizmat, infrastrukturën, institucionet dhe përdoruesit e pagesave, në një vend apo rajon më të gjerë (p.sh. një zonë ekonomike e përbashkët).
Para elektronike "online"	Produkt i parasë elektronike ku regjistrimi i fondeve kryhet në një sistem kompjuterik qendror, të cilat përdoren nëpërmjet qasjes në këtë sistem përmes internetit, duke përdorur një shumëllojshmëri pajisjesh (p.sh. kompjuter, laptop, tabletë, mobil).
Mbikëqyrje³⁴	Mbikëqyrja e sistemeve të pagesave dhe shlyerjeve është një funksion i bankës qendrore, ku objektivi i sigurisë dhe efikasitetit arrihet falë monitorimit të sistemeve ekzistuese dhe atyre të planifikuara, duke i vlerësuar ato kundrejt këtyre objektivave dhe, sipas nevojës, duke nxitur ndryshime. Mbikëqyrja e sistemeve të pagesave ka si target një sistem pagesash të caktuar, në vend të pjesëmarrësve individualë të tij. Në vitet e fundit, shumë banka qendrore kanë zgjeruar aktivitetet e tyre mbikëqyrëse edhe mbi instrumentet dhe shërbimet e pagesave.
Zyrë/sportel pagese	Vendndodhja fizike e të paguarit (p.sh. në rastin e kompanive të shërbimeve) apo paguesit (p.sh. në rastin e agjencive qeveritare) që i mundësojnë përdoruesve të pagesave që të transferojnë dhe të marrin fonde. Këto aktivitete mund të kryhen nëpërmjet sportelistit apo në zonën e vetëshërbimit të zyrës paguese.
Switch i pagesave me kartela	Një mekanizëm që lidh institucione të ndryshme dhe lejon shkëmbimin e transaksioneve të pagesave me kartela të institucioneve pjesëmarrëse si lëshues të kartelave me institucione pjesëmarrëse të pranimit të pagesave me kartela, përmes pajisjeve që ofrohen për tregatarrët, si terminalët POS, transaksioneve përmes ATM-ve dhe pajisjeve tjera të pranimit të kartelave. Një switch i pagesave me kartela përdoret për të drejtuar mesazhet e autorizimit dhe autentifikimit ndërmjet institucioneve pjesëmarrëse, i cili mund të gjeneroj dhe shpërndaj mesazhe të kliringut dhe shlyerjes. Në disa mjedise, institucionet individuale mund të kenë switch'in e tyre për ndërlidhjen e terminaleve POS dhe ATM-ve të tyre me sistemin e tyre të brendshëm për procesimin e pagesave me kartela dhe këto switch'e të brendshme janë të lidhura me ndonjë switch tjetër qendror ndërinstitucional për procesimin e pagesave me kartela. Ky term shpeshherë përdoret në mënyrë të ndërsjellë edhe për skemat e pagesave me kartelë, por ka një dallim të rëndësishëm mes tyre. Switch'i në përgjithësi i referohet infrastrukturës teknike, ndërsa skema e pagesave me kartelë përfshin masat operacionale, produktet e pagesave, rregullat, procedurat, markën e pranimit, etj.
Instrukcion pagese	Një urdhër pagese ose mesazh pagese që instruktin transferin e fondeve të urdhrit të i paguari.
Ofrues i shërbimit të pagesave	Një subjekt që ofron shërbime pagesash, duke përfshirë remitencat. Ofruesit e shërbimit të pagesave përfshijnë bankat dhe institucione të tjera jo-banka (IFJB-të) që ofrojnë shërbime pagesash dhe emetimin e parave elektronike, si edhe subjektet e specializuara si operatorë të transfereve të parave.
Sistem i pagesave	Përbëhet nga një seri instrumentesh, procedurash bankare dhe, tipikisht, nga një sistem për transferimin e fondeve ndërbankare, që sigurojnë qarkullimin e parasë.
Terminal POS	Ky term i referohet përdorimit të kartelave të pagesave në një vend shitje me pakicë. Informacioni i pagesës sigurohet ose nga fatura letër ose nga terminale elektronike, që në disa raste janë të projektuara edhe për transmetimin e informacionit. Në këtë rast, rregullimet e tilla mund të quhen "transfere elektronike të fondeve në pikën e shitjes" (EFTPOS). Në këto raste, terminale lexon informacionin e llogarisë nga shiriti magnetik dhe/ose çipi i kartelës dhe në disa raste pranon edhe PIN'in e kartëmbajtësit; përgatitë një kërkesë autorizimi bazuar mbi transaksionin; transmeton kërkesën e autorizimit tek institucioni; merr përgjigjen e autorizimit; tregon statusin e plotësimit të transaksionit në monitor; dhe printon regjistrimin e transaksionit.

³⁴ Paragrafi i parë i këtij përkufizimi është original i marr nga KSPSH (CPSS 2005) "Central Bank Oversight of Payment and Settlement Systems". Pjesa e dytë është shtuar nga dokumente të ndryshme të Grupit të Bankës Botërore.

Kartelë me parapagim	Produkt i parasë elektronike për përdorim të përgjithshëm, ku regjistrimi i fondeve kryhet në kartelën e pagesës (mbi shirit magnetik apo në çipin me qark integral) ose në një sistem kompjuteri qendror dhe që mund të përdoret nëpërmjet instruksioneve të pagesave specifike të emetuara nga bartësi i kartelës së pagesave.
Pagesë nga distanca	Pagesa kur vendndodhja fizike e paguesit dhe të paguarit nuk përputhen. Pagesa me vlerë të vogël mund të fillohet gjatë transaksionit (ekonomik) ndërmjet paguesit dhe të paguarit (p.sh. urdhër me postë/telefon ose përmes tregëtis elektronike) ose mund të jetë e shkëputur nga transaksioni (ekonomik) bazë (p.sh. pagesa e faturave). Shembuj pagesash nga distanca janë pagesat e iniciuara me postë normale, internet/linja specifike dhe me rrjete telefoni/mobili.
Rrezik i shlyerjes	Rreziku që një shlyerje në një sistem transferesh nuk do të ndodhë si pritët. Ky rrezik mund të përfshijë si rrezikun kreditor edhe atë të likuiditetit.
Shkëmbimi “Switching”	Një sistem elektronik i përdorur për të transferuar instruksione pagesash të iniciuara nga klientët, ndërmjet bankave pjesëmarrëse në tregun e pagesave me vlerë të vogël.
Rrezik sistematik	Rreziku që pamundësia e një pjesëmarrësi për të përmbushur detyrimet e tij kontraktuale, mund t’u mohojë pjesëmarrësve të tjerë fondet që u detyrohen, duke rezultuar në një reaksion zinxhir, ku një numër i madh ose të gjithë pjesëmarrësit në një sistem shlyerjeje, nuk do të jenë në gjendje të përmbushin detyrimet e tyre përkatëse.
Rrjet telefonik / mobil	Rrjet komunikimi me zë apo tekst që u mundëson përdoruesve të shërbimeve të pagesave të përdorin shërbimet, si nxjerrje bilanci ose transfere fondesh, nëpërmjet telefonave fiks apo aplikacioneve të mobilave të mençur.
Llogari e pagesave/ transaksioneve	Përkufizohet gjerësisht si një llogari e mbajtur me një bankë ose një ofrues tjetër të autorizuar dhe/ose të rregulluar të shërbimeve të pagesave dhe emetimit të parave elektronike (duke përfshirë IFJB-të), e cila mund të përdoret për të iniciuar dhe pranuar pagesa. Llogaritë e transaksionit mund të diferencohen më tej në llogaritë e transaksioneve të depozitave dhe në llogari të parasë elektronike.

Shtojca 2. Udhëzimet e Bankës Botërore për Zhvillimin e një Strategjie Gjithëpërfshirëse për Reformimin e Pagesave me Vlerë të Vogël

Grupi i Zhvillimit të Sistemeve të Pagesave i Bankës Botërore (GZHSP) ka zhvilluar një strategji për reformimin e sistemeve të pagesave me vlerë të vogël, e cila përmban një numër rekomandimesh për modernizimin e SKPVV-së.

Korniza është hartuar duke u mbështetur në studime të kaluara të zhvilluara nga vetë Banka Botërore, Komiteti për Sistemet e Pagesave dhe të Shlyerjeve - CPMI, si dhe autoritete të tjera ndërkombëtare dhe kombëtare të përfshira në çështjet e sistemit të pagesave dhe në përvojën globale të mbledhur nga GZHSP-ja përgjatë mbështetjes së reformimit të sistemeve të pagesave në mbi 100 vende.

Korniza bazohet në grupin e mëposhtëm të objektivave të politikave publike:

- Garantimi i sigurisë dhe efikasitetit të përgjithshëm të sistemit kombëtar të pagesave;
- Promovimi i përbalueshmërisë dhe lehtësia e qasjes në shërbimet e pagesave;
- Nxitja e zhvillimit të një infrastrukture efikase për të mbështetur zhvillimin e instrumenteve dhe mekanizmave të pagesave për të përmbushur nevojat për pagesa me vlerë të vogël; dhe
- Nxitja e përdorimit optimal shoqëror të instrumenteve të pagesave.

Për të arritur këto objektiva të politikave publike, Banka Botërore ka formuluar udhëzimet e mëposhtme:

Udhëzimi I: Tregu i pagesave me vlerë të vogël duhet të jetë transparent, të sigurojë mbrojtje të përshtatshme të interesave të paguesve dhe të paguarve dhe të jetë me kosto efektive.

Udhëzimi II: Pagesat me vlerë të vogël kërkojnë infrastrukturë të besueshme financiare, të komunikimit dhe teknike. Këto infrastrukturë duhet të ndërtohen për të rritur efikasitetin e pagesave me vlerë të vogël. Ato përfshijnë: një sistem ndërbankar të transferimit të fondeve elektronike; një platformë ndërbankare të pagesave me kartela; platformën për raportimin e kredive; platformën për shpërndarjen e të dhënave; sistemin ndërbankar të shlyerjes bruto të transaksioneve me vlerë të madhe; një infrastrukturë komunikimi të fortë; si dhe një infrastrukturë kombëtare identifikimi.

Udhëzimi III: Pagesat me vlerë të vogël duhet të mbështeten nga një korniz ligjore dhe rregullative e shëndoshë, e parashikueshme, jodiskriminuese dhe proporcionale.

Udhëzimi IV: Kushtet e tregut konkurrues duhet të nxiten në industrinë e pagesave me vlerë të vogël, me një ekuilibër të përshtatshëm midis bashkëpunimit dhe konkurrencës, për të promovuar, ndër të tjera, nivelin e duhur të ndërveprimit në infrastrukturën e pagesave me vlerë të vogël.

Udhëzimi V: Pagesat me vlerë të vogël duhet të mbështeten nga praktika të përshtatshme të qeverisjes dhe menaxhimit të rrezikut.

Udhëzimi VI: Autoritetet publike duhet të ushtrojnë mbikëqyrje efektive mbi tregun e pagesave me vlerë të vogël dhe të marrin në konsideratë ndërhyrje proaktive aty ku është e përshtatshme.

Shtojca 3: KITP (CPMI) – Banka Botërore “Aspektet e Pagesave të Përfshirjes Financiare”

Përfshirja financiare, e parë nga këndvështrimi i pagesave, duhet të synojë të arrijë një numër objektivash. Në një situatë ideale, të gjithë individët dhe bizneset duhet të jenë në gjendje të kenë dhe të përdorin të paktën një llogari të pagesave/transaksioneve të operuar nga një ofrues i rregulluar i shërbimeve të pagesave:

- Për të kryer pjesën më të madhe, nëse jo të gjitha, të pagesave të nevojshme;
- Për të ruajtur në mënyrë të sigurt vlerën e mjeteve monetare; dhe
- Për t’ju shërbyer si një dritare drejt shërbimeve tjera financiare.

Në këtë kontekst, u identifikuan Parimet Udhëzuese në vijim. Secili prej tyre përfshin një sërë veprimesh të mundshme (të cilat nuk paraqiten në këtë shtojcë).

Parimi udhëzues 1: *Angazhimi i sektorit publik dhe privat.* Angazhimi i institucioneve të sektorit publik dhe atij privat për të zgjeruar përfshirjen financiare është i qartë, i fortë dhe i qëndrueshëm në kohë.

Parimi udhëzues 2: *Korniza ligjore dhe rregullative.* Korniza ligjore dhe rregullative mbështet përfshirjen financiare, duke adresuar në mënyrë efektive të gjitha rreziqet përkatëse, duke mbrojtur konsumatorët dhe nxitur në të njëjtën kohë inovacionin dhe konkurrencën.

Parimi udhëzues 3: *Infrastrukturat financiare dhe TIK.* Infrastrukturat financiare dhe TIK të forta, të sigurta, efikase dhe të arritshme për të gjithë, janë të dobishme për ofrimin e shërbimeve të llogarive të transaksioneve, si dhe mbështesin një shpërndarje më të gjerë të shërbimeve financiare.

Parimi udhëzues 4: *Llogaria e transaksionit dhe hartimi i produktit të pagesave.* Llogaria e transaksionit dhe oferta e produkteve të pagesave përmbushin në mënyrë efektive një gamë të gjerë të nevojave të transaksioneve të popullatës së synuar, me një kosto të ulët ose pa kosto.

Parimi udhëzues 5: *Pika të qasjes lehtësisht të disponueshme.* Dobia e llogarive të transaksioneve shtohet me një rrjet të gjerë pikash të qasjes, të cilat arrijnë një mbulim të gjerë gjeografik dhe ofrojnë një shumëllojshmëri kanalesh ndërvepruese të qasjes.

Parimi udhëzues 6: *Ndërgjegjësimi dhe edukimi financiar.* Individët fitojnë njohuri, përmes ndërgjegjësimit dhe përpjekjeve për edukim financiar, mbi përfitimet e posedimit të llogarive të transaksioneve, si t'i përdorin këto llogari në mënyrë efektive për qëllimet e pagesës dhe të ruajtjes së fondeve dhe si të qasen në shërbime të tjera financiare.

Parimi udhëzues 7: *Flukset e mëdha, të përsëritura të pagesave.* Flukset e mëdha, të përsëritura të pagesave, duke përfshirë remitencat/dërgesat e emigrantëve, përdoren për të avancuar objektivat e

përfshirjes financiare, domethënë duke rritur numrin e llogarive të transaksioneve dhe duke nxitur përdorimin e shpeshtë të këtyre llogarive.

Shtojca 4: KSPSH (CPSS) – Banka Botërore “Parimet e Përgjithshme për Shërbimet Ndërkombëtare të Remitencave / Dërgesave të Emigrantëve” dhe Role të Ngjashme

PARIMET E PËRGJITHSHME PËR SHËRBIMET E REMITENCAVE

Parimet e përgjithshme synojnë të përmbushin objektivat e politikës publike për arritjen e shërbimeve të sigurt dhe efikase të dërgesave ndërkombëtare të emigrantëve. Për këtë qëllim, tregjet për shërbimet duhet të jenë konkurruese, transparente, të qasëshme dhe të shëndosha.

Transparenca dhe mbrojtja e konsumatorit

Parim i përgjithshëm 1. Tregu i remitencave duhet të jetë transparent dhe të ofrojë mbrojtje të përshtatshme të konsumatorit.

Infrastruktura e sistemit të pagesave

Parim i përgjithshëm 2. Duhet inkurajuar përmirësimet në infrastrukturën e sistemit të pagesave që mund të rrisin efikasitetin e shërbimeve të remitencave.

Ambienti ligjor dhe rregullativ

Parim i përgjithshëm 3. Shërbimet e remitencave duhet të mbështeten nga një kornizë ligjore dhe rregullative e shëndosh, e parashikueshme, jodiskriminuese dhe proporcionale, e aplikuar në juridiksionin përkatës.

Struktura e tregut dhe konkurrenca

Parim i përgjithshëm 4. Kushtet e konkurrencës së tregut, duke përfshirë qasjen e duhur në infrastrukturën e pagesave të brendshme, duhet të nxitin edhe në industrinë e remitencave.

Qeverisja dhe administrimi i rrezikut

Parim i përgjithshëm 5. Shërbimet e remitencave duhet të mbështeten nga praktika të përshtatshme qeverisjeje dhe administrimi të rrezikut.

ROLET E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË REMITENCAVE DHE AUTORITETEVE PUBLIKE

A. Roli i ofruesve të shërbimit të remitencave. Ofruesit e shërbimeve të remitencave duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në zbatimin e parimeve të përgjithshme.

B. Roli i autoriteteve publike. Autoritetet publike duhet të vlerësojnë se çfarë veprimesh duhen ndërmarrë për të arritur objektivat e politikave publike, nëpërmjet zbatimit të parimeve të përgjithshme.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web:www.bqk-kos.org